Projekti STAR

Udhëzues mbi Kontrollin e Njësisë së Qeverisjes Vendore

Fjalor

Agjensia	Agjensia e Inventarizimit të Pronave Publike në Ministrinë e Brendshme
ALL	Lek
AMK	Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit
APP	Agjensia e Prokurimit Publik
AQT	Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara
BNJ	Burimet Njerëzore
CD	Kompakt Disk
Db	Debi
F	Format
Format 1 deri në 11	Pasqyrat financiare të plotësuara bazuar në Format 1 deri në 11, sipas kërkesave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitur nga NJQV
GA	Gabim kontabël
KKRT	Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit
Kr	Kredi
Ligji Organik	Ligji Organik për Qeverisjen Vendore
MF	Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë
MP	Modifikim i politikave
N/A	Nuk aplikohet
NIPT	Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm
Nj.A	Njesi administrative
Nj.Q.H.K.B	Njësia qëndrore e harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
Nr.	Numër
Pasqyrat Finaciare	Pasqyrat financiare të plotësuara bazuar në Format 1 deri në 11, sipas kërkesave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitur nga NJQV
PF	Pasqyra Financiare
PNP	Punime në progres
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RAT	Reforma Administrative Territoriale
RI	Riklasifikim
Shënime nga 1 në 13	Informacioni shtesë që do të përgatitet nga NJQV ne lidhje me kontrollin financiar
TI	Teknologjia e Informacionit
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UISH	Udhëzimet e institucioneve shtetërore
VF	Viti Financiar
VKK	Vendimi i Këshillit Komunal
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
VNK	Vlera neto kontabël

Përmbajtja

Hyrje 4
Figura: Procesi dhe Korniza Kohore e Amalgamimit 5

Kontrolli Operacional 8

1 Planifikimi 10
1.1 Njohja me kuadrin ligjor 10
1.2 Të kuptuarit e Modelit Organizativ 10
1.3 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për transferimin e personelit 13
1.4 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për arkivimin 14
1.5 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për menaxhimin e aktiveve 14
1.6 Personalizimi i pyetësorëve për informacion dhe Librit të të dhënave (Databook) operacionale 15
1.7 Paraqitja e pyetësorit për informacion dhe Librit të të dhënave (Databook) operacional 15
1.8 Organizimi i vizitave dhe takimeve të planifikuara paraprakisht 16

2 Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave 17
2.1 Organizimi dhe struktura 17
2.1.1 Strukturat administrative dhe përgjegjësitë 17
2.1.2 Disponueshmëria e shërbimeve publike dhe funksioneve horizontale 18
2.2 Çështjet e personelit 19
2.3 Teknologjia e Informacionit 20
2.3.1 Inventari i sistemeve të informacionit, hardware-ve dhe kontratave të mirëmbajtjes 20
2.3.2 Vlerësimi i kontrolleve të TI të zbatuara në sistemet e informacionit dhe të Mjedisit TI 21
2.3.3 Testimi i kontrolleve të automatizuara rreth menaxhimit financiar të të dhënave dhe gjenerimi i raporteve financiare 21
2.4 Sistemet e komunikimit 21
2.4.1 Inventari i telefonisë dhe marrëveshjeve të internetit që ekzistojnë në NJQV 21
2.4.2 Të kuptuarit e metodave tëkomunikimit të brendshëm të aplikuara në NJQV në kuadër të qëllimit d.m.th mjetet e komunikimit, memo formale protokollare, email-e etj 22
2.5 Arkivimi 22
2.6 Menaxhimi i Aktiveve 24
2.7 Projektet e Investimeve 24
2.8 Çështjet ligjore 25
2.8.1 Kontratat e Shërbimeve Publike 25
2.8.2 Çështjet Gjyqësore 25
2.8.3 Kontratat me palët e treta 25

3 Analiza dhe përgatitja për konsolidim 27
3.1 Organizimi dhe struktura 27
3.2 Çështjet e personelit 29
3.3 Teknologjia e informacionit 29
3.4 Komunikimi 30
3.5 Arkiva 30
3.6 Menaxhimi i aktiveve 30
3.7 Projektet e Investimeve 31
3.8 Çështjet ligjore 32
3.8.1 Kontrata e shërbimeve publike 32

4 Konsolidimi 33
4.1 Organizimi dhe struktura 33

4.1.1 Mo deli i Ardhshëm Organizativ 33
4.1.2 Struktura e ardhshme organizative 36
4.2 Çështjet e personelit 38
4.3 Teknologjia e informacionit 38
4.4 Komunikimi 38
4.5 Arkiva 39
4.6 Menaxhimi i aktiveve 39
4.7 Projektet e Investimeve 39
4.8 Çështjet ligjore 39
4.8.1 Kontratat e shërbimeve publike 39
4.8.2 Procedurat ligjore 39
4.8.3 Kontratat me palë të treta 39

Kontrolli financiar 40

5 Planifikimi 42
5.1 Njihuni me kuadrin raportues 42
5.2 Përshtatni Pyetësorin për informacion dhe Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare për NJQV-në 42
5.3 Dorëzoni Pyetësorin për informacion duke përfshire Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare 42
5.4 Organizoni vizitat në terren dhe programoni takimet paraprakisht 42

6 Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave 43
6.1 Mblidhini të dhënat sipas *Pyetësorit për informacion* dhe sigurohuni për plotësinë dhe saktësinë e tyre 43
6.2 Kryeni procedurat e përshkruara për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet 43
6.2.1 Buxheti 43
6.2.2 Inventari 43
6.2.3 Debitorët dhe të tjera të arkëtueshme 44
6.2.4 Balanca e parasë së gatshme 44
6.2.5 Kreditorët, kreditë dhe huazimet 44
6.2.6 Shpenzime 44
6.2.7 Të ardhurat 45
6.2.8 Investimet në filiale 45
6.2.9 Grantet nga donatorë të huaj 45

7 Analizë dhe përgatitje për konsolidim 46
7.1 Siguroni pasqyrat financiare individuale për çdo NJQV duke u bazuar në të dhënat e mbledhura 46
7.2 Hidhini të dhënat në Modelin Financiar 46
7.2.1 Hedhja e të dhënave në Faqet e Informacionit të Përgjithshëm dhe të Formave të Pasqyrave financiare 47
7.2.2 Informacioni i përgjithshëm 47
7.2.3 Transferoni të dhënat në formatin e Pasqyrave financiare 49
7.2.4 Transferoni të dhënat në evidencën e marrë 49
7.2.5 Plotësimi i Shënimeve mbi Pasqyrat financiare 50
7.2.6 Kontrolli për Pasqyrat financiare 50
7.2.7 Plotësim automatik i formateve të Pasqyrave financiare 51
7.2.8 Plotësimi automatik i faqes Kontrolle (Checks) 51
7.2.9 Analizoni evidencën e dhënë për të mbështetur plotësinë dhe saktësinë e Pasqyrave Financiare 52

7.3 Kryeni rregullimet (sistemimet) kontabël, pasqyrojini në shifrat e riparaqitura dhe kontrolloni për koherencë 61
7.3.1 Rishikoni Kontrollet (checks) për koherencë dhe pyesni NJQV-në në lidhje me gabimet në rakordime, nëse ka 62
7.3.2 Kopjimi i Formave në raport 62
7.4 Analizoni Pasqyrat financiare 64
7.4.1 Performanca më e fundit financiare 64
7.4.2 Dobësitë e identifikuara në proçeset kontabël 65
7.4.3 Pasqyrat financiare 66
7.4.4 Shënime mbi Pasqyrat financiare 72
7.4.5 Buxheti VF 2015 78
7.5 Përgatisni dokumentet për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve 78

8 Konsolidimi 79
8.1 Përmblidhni regjistrat me vehte të aktiveve të qëndrueshme dhe vazhdoni me vlerësimin 79
8.2 Pasqyroni rezultatet e vlerësimit në pasqyrat financiare më vehte dhe në Modelin financiar 79
8.3 Plotesimi i modelit të konsoliduar financiar 80
8.3.2 Transferimi i shifrave të riparaqitura 82
8.3.3 Plotësimi i F1 restated (F1 i riparaqitur), F2 restated (F2 i riparaqitur), F3-1 restated (F3-1 i riparaqitur) dhe F3-2 restated (F3-2 i riparaqitur) 83
8.3.4 Përgatitja e grafikeve për raportin 85
8.4 Analizimi i gjendjes së konsoliduar financiare 86
8.4.1 Transferimi i tabelave të raporti i Kontrollit financiar të konsoliduar 86
8.4.2 Shtojcat 87
8.5 Tregoni rreziqet e mundshme për bashkinë e re në vijim të bashkimit 88

Shtojcat në kopje elektronike 89
Shtojca 1: Pyetësor për informacion 89
Shtojca 2: Kuadri ligjor 89
Shtojca 3: Libër i të dhënave operacionale 89
Shtojca 4: Formati i raportit të kontrollit operacional 89
Shtojca 5: Modeli financiar për një NJQV 89
Shtojca 6: Formatet për Shënimet mbi pasqyrat financiare 89
Shtojca 7: Formati i raportit të kontrollit financiar 89
Shtojca 8: Udhëzimi mbi vlerësimin e aktiveve 89
Shtojca 10: Përshkrimi i përmbajtjes së Modelit Financiar 90
8.5.1 Përshkrimi i detajuar i përmbajtjes së workbook (dokumenti në excel) 90
Shtojca 11: Përshkrim i Modelit Financiar të Konsoliduar 101

Kufizimi i përgjegjësisë 102

Hyrje

Informacion i përgjithshëm

Qeveria e Shqipërisë, (QSH) ka ndërmarrë një reformë administrative-territoriale (RAT), e cila synon krijimin e njësive më të mëdha të qeverisjes vendore, duke administruar një territor më të madh, të riorganizuar dhe konsoliduar.

Përfitimet e parakohshme të një reforme të tillë janë të shumëfishta, me një objektiv final të RAT për të forcuar efiçencën e administratës vendore, të demokratizojë dhe forcojë më tej qeverisjen në vend dhe të inkurajojë efiçencën ekonomike me anë të krijimit të kushteve të një planifikimi të integruar në një hapësirë administrative më të konsoliduar.

Në mbështetje të kësaj reforme, komuniteti i donatorëve ka krijuar një fond multi-donator nën menaxhimin e UNDP Albania, i njohur si "Projekti Mbështjetje për Reformën Territoriale Administrative (STAR). Projekti STAR është krijuar me qëllimin për të ofruar mbështetje koherente teknike, operacionale dhe logjistike ndaj procesit të reformës me anë të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV) – institucioni qëndror përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e reformës.

Më tej, një Grup Amalgamimi i MSHÇV është krijuar dhe një përqasje pilot është kryer në hartimin dhe zhvillimin e modaliteteve që do të aplikohen në një shkallë kombëtare/të plotë. Dy grupe përfaqësuese të dymbëdhjetë njësive të qeverisjes vendore (NJQV) janë përzgjedhur dhe do të përbëjnë bashkitë e reja të Pogradecit dhe Urës Vajgurore.

KPMG Albania Shpk (KPMG) është përzgjedhur për të asistuar në përmbushjen e objektivave kryesorë të fazës tranzitore në hartimin dhe testimin e përqasjes së amalgamimit duke drejtuar një kontroll gjithëpërfshirës në dymbëdhjetë NJQV pilot. Mbi këtë bazë, një përqasje koherente, udhëzime dhe modele për të përsëritur ushtrimin e kontrollit janë zhvilluar. KPMG gjithashtu realizoi një seancë Trajnimi të Trajnuesve për krijimin e kapaciteteve për të vazhduar procesin e amalgamimit.

Procesi dhe Korniza ligjore e Amalgamimit

Procesi i amalgamimit është mbështetur në legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrative-territoriale", dhe
- Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore"
- Projektligji që ndryshon Ligjin nr. 8652 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i cili është aprovuar nga Parliamenti Shqiptar (por nuk ka hyrë ende në fuqi).

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet e pritura:

- 373 njësi ekzistuese të qeverisjes vendore do të konsolidohen në 61 bashki të reja që do të krijohen pas zgjedhjeve vendore në 21 Qershor 2015
- Secila nga bashkitë e reja do të përbëhet nga disa njësi administrative dhe do të përfaqësojnë një unitet territorial-administrativ.
- Njësitë ekzistuese të qeverisjes vendore do të vazhdojnë funksionimin e tyre deri sa të krijohen organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkive të reja.
- Amalgamimi duhet të marrë formën e një bashkimi ligjor efektiv; për shkak të kompleksitetit të tij, procesi do të kërkojë hapa të mëtejshëm për të finalizuar strukturat e reja në praktikë.
- Bashkimi ligjor efektiv do t'i korrespondojë datës së konstituimit të çdo bashkie të re që mund të variojë bazuar në procesin zgjedhor.
- Procesi dhe korniza kohore e amalgamimit janë ilustruar në figurën e mëposhtme.

Figura: Procesi dhe Korniza Kohore e Amalgamimit



Qëllimi i Udhëzuesit për Kontrollin e Njësive të Qeverisjes Vendore

- Ndërmarrja e një kontrolli gjithëpërfshirës për gjendjen e punëve për çdo NJQV ekzistuese është një hap thelbësor për të pasur një tablo të qartë të veprimeve të amalgamimit të qeverisjes vendore dhe problemeve që mund të adresohen në çdo rast specifik.
- Udhëzimi i pranishëm për Kontrollin e Njësive të Qeverisjes Vendore (Udhëzimi) do të shërbejë si një hartë për:
  - Kryerjen e detyrave të kontrollit
  - Përgatitjen e dokumenteve të nevojshëm për bashkimin efektiv ligjor dhe
  - Nënvizimi i hapave të mëtejshëm për të finalizuar amalgamimin me sa më pak probleme në praktikë
- Një set i shumëllojshëm mjetesh është krijuar për të lehtësuar përmbushjen e detyrave, përfshirë politikat, metodologjitë, pyetësorët, udhëzimet, librat e të dhënave (data books), dhe një model financiar gjithëpërfshirës. Përdorimi i tyre shpërndahet nga planifikimi dhe marrja e informacionit për analizë dhe raportim uniform.
- Dokumentet e mëposhtëm të nevojshëm për bashkimin efektiv ligjor mund të zhvillohen duke përdorur Udhëzimin :
  - Lista e aktiveve të qëndrueshme
  - Lista e inventarëve ekonomikë dhe materialeve
  - Lista e kontratave me palët e treta
  - Lista e bilanceve me debitorët dhe kreditorët referuar te kontratat
  - Akti i Trashëgimisë i përputhur me Thesarin
  - Të ardhurat dhe shpenzimet
  - Lista e investimeve të degëve
  - Lista e personelit
  - Lista e çështjeve gjyqësore
  - TI dhe inventari i sistemeve të komunikimit
  - Buxheti i miratuar për 2015
- Raportet e mëposhtme për fazën post-bashkimit mund gjithashtu të përgatiten:
  - Pasqyrat financiare të veçanta për secilën NJQV ekzistuese në datën efektive të bashkimit
  - Pasyrat financiare të konsoliduara për bashkinë e re në datën efektive të bashkimit
  - Vlerësimi i aktiveve të qëndrueshme
  - Konsolidimi i veprimeve
- Për përfundimin e procesit të amalgamimit akte ligjore priten të amendohen dhe aktet nenligjore të miratohen për të parashikuar procedurat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit dhe arkivave. Prandaj, mund të jetë e nevojshme që Udhëzimi i pranishëm të ndryshohet për të reflektuar plotësisht kërkesat e reja ligjore.

Përqasja e kontrollit

Udhëzimi është ndarë në hapat e mëposhtëm në rend kronologjik:

Planifikimi

Gjatë hapit të planifikimit grupet e kontrollit duhet të planifikojnë me kujdes dhe të nisin mbledhjen e të dhënave, të përshtasin pyetësorët standard që u janë vënë në dispozicion dhe të planifikojnë vizita në terren dhe intervista me përfaqësuesit e NJQV-ve përkatëse.

Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave

Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave duhet të fokusohet në mbledhjen e informacionit cilësor dhe sasior nga pyetësorët.

Grupet duhet të sigurojnë që personeli i NJQV-ve të kuptojë të gjitha kërkesat për informacionin dhe të dhënat e mbledhura të jenë të plota dhe të paraqitura rregullisht. Planifikimet do të mundësojnë për disa raunde qarkullimin e informacionit dhe intervistave.

Analiza dhe përgatitja e konsolidimit

Si pjesë e hapit të analizës dhe konsolidimit grupet e amalgamimit do të standardizojnë, përputhin dhe analizojnë të dhënat operacionale dhe financiare të NJQV-ve.

Qëllimi është përgatitja e raporteve të veçanta koherente për secilën NJQV, e cila do të lejojë konsolidimin e njëllojtë operacional dhe financiar të Bashkisë se Re që do të krijohet.

Puna e kryer do të përgatisë gjithashtu NJQV-të për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Konsolidimi

Gjatë hapit të konsolidimit grupet e kontrollit priten të përmbledhin të dhënat dhe të ofrojnë një skemë të organizimit për çështjet operacionale dhe funksionale të NJQV.

Një aspekt i rëndësishëm i punës është identifikimi dhe adresimi i risqeve të rëndësishme potenciale si pasojë e bashkimit.

Përmbajtja e Udhëzimit

Përmbajtja është organizuar në tre seksione si më poshtë:

Kontrolli Operacional	**Kontrolli Financiar**
Organizimi dhe struktura	Performanca financiare
Çështjet e Personelit	Pasqyrat financiare
Teknologjia e Informacionit	Shënime në pasyrat financiare
Sistemet e Komunikimit	Buxheti
Arkiva	
Menaxhimi i Aktiveve	
Projektet e Investimeve	
Çështjet ligjore	
Shtojcat në formë elektronike	
1: Pyetësori për Informacionin	7: Modeli i Raportit të Kontrollit Financiar
2: Kuadri Ligjor	8: Udhëzime mbi vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme
3: Libri i të dhënave operacionale (data books)	9: Modeli Financiar i konsoliduar
4: Modeli i Raportit të Kontrollit Operacional	10: Përshkrime të përmbajtjes së Modelit Financiar
5: Modeli Financiar Individual	11: Përshkrime të përmbajtjes së Modelit Financiar të Konsoliduar
6:Modelet e Shënimeve të Pasqyrave Financiare	

Udhëzimi, përfshirë shtojcat, është paraqitur në kopje elektronike në një CD, që është pjesë integrale e këtij dokumenti. Për shkak të specifikave, shtojcat janë paraqitur vetëm në kopje elektronike.

Kontrolli Operacional

Procesi Operacional

Një pasqyrë e procesit të kontrollit operacional dhe të aktiviteteve kryesore që do të ndiqen gjatë çdo hapi janë paraqitur më poshtë.

Me një klikim mbi ikonën mund të shkoni në seksionin përkatës.

Planifikim

- Njohja me *Kuadrin ligjor*
- Të kuptuarit e *Modelit Organizativ*
- Të kuptuarit e kërkesave ligjore për transferimin e personelit
- Të kuptuarit e kërkesave ligjore për arkivimin
- Të kuptuarit e kërkesave ligjore për menaxhimin e aktiveve
- Personalizimi i *Pyetësorëve për informacion* dhe *Librit të të dhënave (Databook) operacionale*
- Paraqitja e *Pyetësorëve për informacion* dhe *Librit të të dhënave (Databook) operacionale*
- Organizimi i vizitave dhe takimeve të planifikuara paraprakisht

Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave

- Organizimi dhe struktura
- Çështjet e personelit
- Teknologjia e informacionit
- Sistemet e komunikimit
- Arkiva
- Menaxhimi i aktiveve
- Projektet e Investimeve
- Çështjet ligjore

Analiza dhe përgatitja për konsolidim

- Modeli dhe struktura organizative
- Çështjet e personelit
- Teknologjia e informacionit
- Sistemet e komunikimit
- Arkiva
- Menaxhimi i aktiveve
- Projektet e investimeve
- Çështjet ligjore

Konsolidimi

- Organizimi dhe struktura
- Çështjet e personelit
- Teknologjia e informacionit
- Sistemet e komunikimit
- Arkiva
- Menaxhimi i aktiveve
- Projektet e investimeve
- Çështjet ligjore

1 Planifikimi

1.1 Njohja me kuadrin ligjor

Një kuadër ligjor i përbashkët për shërbimet publike ("Kuadri Ligjor") është krijuar duke rishikuar legjislacionin ekzistues në lidhje me çështjet e qeverisjes vendore, duke përfshirë:

- Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, ("Ligji Organik")
- Ligji Nr. 115/2014, datë 31.7.2014, "Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"
- 34 ligje të sektorëve të industrisë
- 5 vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)
- 2 udhëzime të Institucioneve të Qeverisjes Qendrore

Kuadri ligjor është paraqitur në Shtojcën 2.

1.2 Të kuptuarit e Modelit Organizativ

Bazuar në analizat e kryera gjatë fazës pilot dhe në praktikat më të mira, është zhvilluar një Model Organizativ i NJQV-ve ekzistuese. Më tej, faktorët nxitës për ndryshim janë marrë në konsideratë dhe modeli u përshtat për të reflektuar statusin e ardhshëm të kërkuar për NJQV-të.

Modeli aktual organizativ përbëhet nga katër elementë: rolet, funksionet, orientimi dhe dhënia e shërbimeve siç tregohet në Figurën 2. Këta elemente do të analizohen për organizimin e çdo NJQV-je ekzistuese.

Figura 2: Modeli aktual organizativ

Rolet

Rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse janë përcaktuar në Kuadrin Ligjor dhe përfshijnë:

- Këshillin e NJQV-së
- Kryetarin e NJQV-së
- Nënkryetarin e NJQV-së
- Sekretarin e Këshillit të NJQV-së

Funksionet

Funksionet e kryera nga NJQV-ja klasifikohen gjerësisht si vijon:

- Funksione të shërbimit publik, dhe
- Funksione horizontale

Më tej, Ligji Organik përcakton kategoritë për dhënien e funksioneve të shërbimeve publike, që janë funksione të veta, të përbashkëta dhe të deleguara.

Orientimi

Llojet e orientimit të përdorura gjerësisht në modelin aktual janë:

- Ndarje sipas sektorit

  Orientimi i ndarjes sipas sektorit u referohet sektorëve të shërbimit publik që janë në shërbim të komunitetit. Për shembull, strukturat administrative të NJQV-së janë organizuar për të siguruar planifikimin e infrastrukturës dhe zhvillimin, shërbimin veterinar, mbrojtjen civile dhe të tjera.

  Grupimi i pozicioneve individuale është orientuar drejt ciklit të plotë të dhënies së shërbimit specifik – që nga hartimi i programit / politikave të përgjithshme deri tek plani i veprimit dhe ndërmarrja e hapave zbatuese. Një strukturë e tillë mundëson përgjegjshmëri të qartë, koordinim të përmirësuar të aktiviteteve, dhe ndërton ekspertizë që ndihmon në përmirësimin e dhënies së shërbimeve.

- Funksional

  Grupimi i pozicioneve individuale sipas strukturës funksionale bazohet në funksione të përbashkëta të tilla si Burimet Njerëzore, Financa, Teknologjia e Informacionit, etj.

  Puna është e ndarë në detyra që janë më tepër teknike sesa të orientuara drejt biznesit brenda zonës funksionale. Një strukturë e tillë mundëson efiçencë si dhe standardizim dhe optimizim të procesit / politikave.

Dhënia e shërbimeve

Për kryerjen e funksioneve të veta, administrata e qeverisjes vendore mund të përdorë:

- Burime të veta për ofrimin e shërbimeve publike ndaj komunitetit dhe kryerjen e funksioneve horizontale.
- Licensimin e operatorëve privatë për të ofruar shërbime të caktuara (si p.sh. transporti publik)

Kontraktimin e palëve të treta ose të institucioneve publike të tjera

Figura 3: Modeli i ardhshëm organizativ

Modeli organizativ i bashkive të reja njësive administrative do të udhëhiqet nga nevoja për ndryshim për të arritur objektivat e procesit të amalgamimit. Ndryshimet janë të përcaktuara në projektligjin i cili përmban ndryshime të Ligjit Organik. Projektligji është aprovuar nga Parliamenti Shqiptar (por nuk ka hyrë ende në fuqi).

Bazuar në analizën e natyrës dhe ndikimit të tyre, Modeli Organizativ i ardhshëm është ndërtuar, siç është paraqitur në Figurën 3.

Disa nga ndryshimet do të zbatohen menjëherë, ndërsa të tjerat do të kenë nevojë për punë përgatitore afatshkurtër dhe afatmesme.

Rolet e ardhshme

Ndryshimet në role do të zbatohen me efekt të menjëhershëm.

- Këshilli i NJQV-së do të vazhdojë kompetencat ekzistuese. Për të ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit të Bashkisë së re, përgjegjësitë e saj do të ndryshojnë si vijon:
  - Miratimi i nivelit të pagave dhe shpërblimeve për punonjësit dhe personat e tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin
  - Me miratimin e buxhetit dhe ndryshimet e tij, ajo gjithashtu do të miratojë numrin maksimal të të punësuarve dhe institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.
- Kryetari i bashkisë do të vazhdojë me kompetencat ekzistuese. Për të ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit të Bashkisë së Re, ai do të marrë përgjegjësi të reja, përkatësisht:
  - Miratimi i strukturës organizative të Bashkisë së Re dhe të gjitha rregulloret shoqëruese të brendshme për organizimin e aktiviteteve të administratës bashkiake dhe të njësive buxhetore bashkiake
  - Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve të njësive administrative dhe të lagjeve.
- Administratori është një rol i ri. Personi emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i bashkisë dhe ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:
  - Të drejtojë njësinë administrative dhe t'i raportojë Kryetarit të Bashkisë për funksionimin e saj
  - Të konstatojë dhe shqyrtojë rastet e kundërvajtjeve administrative
  - Ka të drejtë të delegojë kompetencat e veta në lidhje me identifikimin dhe shqyrtimin e rasteve të kundërvajtjeve administrative për punonjësit e tjerë të njësisë administrative
- Nënkryetari i bashkisë do të vazhdojë me kompetencat ekzistuese. Ai do të emërohet nga Kryetari i bashkisë.
- Sekretari i NJQV-së do të vazhdojë me kompetencat ekzistuese. Ai do të emërohet nga Këshilli i NJQV-së.

Funksionet e ardhshme

- Funksionet që do të kryhen nga bashkitë e reja dhe njësitë administrative janë duke u shqyrtuar nga Qeveria. Një ligj i ri për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, i cili do të përcaktojë funksione të reja të shërbimeve publike dhe do të zëvendësojë Ligjin Organik ekzistues, pritet të miratohet. Prandaj, ndryshimet e ardhshme të funksioneve siç janë të përshkruara në modelin organizativ aktual nuk janë marrë në konsideratë në raportin e kontrollit.

Orientimi i ardhshëm

- Në bazë të analizës së kryer, nuk ka arsye ligjore ose të biznesit për të ndryshuar ndarjen ekzistuese sipas sektorëve dhe orientimin funksional të modelit organizativ në lidhje me shërbimet publike dhe funksionet horizontale.
- Procesi i amalgamimit, megjithatë, paraqet një ndryshim të madh në marrëdhëniet midis Bashkisë së Re dhe njësive administrative:
  - Njësitë administrative janë konsideruar zyra të shërbimit publik dhe mundësojnë ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin në të njëjtën nivel pavarësisht vendndodhjes territoriale
  - Strukturat organike të njësive administrative janë pjesë e strukturës organike të Bashkisë së Re
  - Administrimi i njësisë administrative mbështet aktivitetet e Bashkisë së re
- Ky ndryshim sjell një dimension të ri orientimit të modelit organizativ, që është ndarja sipas gjeografisë

Si pasojë, ekziston nevoja për të zbatuar një strukturë organizative matricë duke kombinuar elementet e ndarjes në sektorë, ndarjen sipas gjeografisë dhe orientimin funksional.

Orientimi do të jetë më kompleks që do të kërkojë linja të shumëfishta të raportimit, ndërmjet ndarjeve dhe funksioneve, planifikim dhe përdorim të burimeve të kombinuara, vendimmarrje, bashkëveprim dhe komunikim. Për të arritur një ndikim pozitiv të ndryshimit, një analizë të detajuar dhe hartimi i

proceseve të reja të punës dhe shtresave të reja stafit, do të duhet të kryhet pas bashkimit efektiv ligjor.

Dhënia e shërbimeve në të ardhmen

- Mënyra se si kryhet puna dhe shpërndahet në dhënien e shërbimeve publike dhe ekzekutimin e funksioneve horizontale, duhet marrë në konsideratë. Kjo qasje do të ndihmojë në përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit në dhënien e shërbimeve.
- Vendime të tilla nuk mund të arrihen në një periudhë afat-shkurtër dhe puna përgatitore është e nevojshme për të analizuar proceset, për të vlerësuar kapacitetet e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës aktuale, duke përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.
- Për të lehtësuar këtë proces analize, kemi hartuar tre pyetje si më poshtë, për t'u përdorur si principe zhvilluese:
    1. Kryerja e punës kërkon prezencë fizike?
    2. Ekziston ndonjë arsye (ligjore, strategjike) për të centralizuar ekzekutimin e funksionit?
    3. Puna është e shkallëzuesshme nëpërmjet kryerjes në distancë/ procesim i centralizuar? (d.m.th. a mundësohet efiçencë me levizjen e detyrave që të kryhen në distancë / procesim i centralizuar)
- Aplikimi i principeve të mësipërme zhvilluese për çdo funksion, do të nxisë zhvillimin e strukturave organizative alternative, të cilat më pas duhet të rafinohen dhe të përzgjidhet ajo strukturë që është më e realizueshmja.

Për më shumë detaje ju lutemi referojuni seksionit *Organizimi dhe Struktura të Librit të të dhënave (Databook) Operacional*e, të paraqitur në Shtojcën 3.

1.3 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për transferimin e personelit

Nga data efektive e bashkimit ligjor, organet kompetente të bashkive të reja duhet të ndërmarrin veprime në lidhje me transferimin e personelit nga NJQV-të që do të pushojnë së ekzistuari në bashkitë e reja. Ky transferim do të bëjë të nevojshëm ristrukturimin e organizimit të brendshëm të bashkive. Për këtë arsye, mund të jetë i nevojshëm ndërprerja e marrëdhënieve me personelin.

Personeli i NJQV-ve është i ndarë në dy kategori: kategoria e nëpunësve civil marrëdhënia me të cilët rregullohet nga Ligji nr. 152/2013, datë 2013/05/30, "Për Nëpunësin Civil" dhe kategoria e punëmarrësve marrëdhënia e me të cilët rregullohet nga Kodi i Punës. Prandaj, procedura të ndryshme duhet të ndiqen nga organet kompetente për ripozicionimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve me nëpunësit civilë dhe punëmarrësit.

Në raste të tilla, dispozitat e neneve 105, 107, 143-145, 147 dhe 148 të Kodit të Punës janë të zbatueshme për trajtimin e punëmarrësve.

Në lidhje me nëpunësit civilë, do të jenë të zbatueshme dispozitat e këtyre akteve ligjore dhe nënligjore:

- Nenet 50/1/6 dhe 7 të Ligjit nr. 152/2013, datë 2013/05/30, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar
- VKM nr. 118, datë 2014/05/03, "Për Procedurat për emërimin, rekrutimin, menaxhimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të shërbimit civil të nëpunësve civil të nivelit të menaxhimit të lartë dhe anëtarëve të TND"
- VKM nr. 143, datë 2014/12/03, "Për Procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës provuese, lëvizjes paralele dhe promovimit të nëpunësve civil të ekzekutivit, kategorive të mesëm dhe të ulët të menaxhimit"

Për më shumë detaje ju lutemi referohuni Librit të të dhënave (Databook) Operacionale, të paraqitur në Shtojcën 3.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave për personelin është që të përgatitet një inventar të plotë të personelit të NJQV-ve për t'u transferuar në bashkinë e re në datën efektive të bashkimit ligjor. Mbi këtë bazë, organet kompetente të Bashkisë së re do të jenë në gjendje të analizojnë dhe vlerësojnë trajtimin e personelit (p.sh. rivendosjen ose ndërprerjen e marrëdhënieve) pas miratimit të strukturës organizative, me qëllim për të rritur efikasitetin dhe kapacitetet për të ofruar shërbime publike në të njëjtin nivel në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Re.

1.4 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për arkivimin

Themelimi, organizimi dhe funksionimi i arkivave rregullohet nga ligji nr. 9154, datë 2003/06/11, "Për Arkivat" (referuar në vazhdim si "Ligji"). Ky ligj është i zbatueshëm për të gjitha institucionet shtetërore, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore. Në përputhje me nenin 15 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka miratuar "Normat teknike-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit të arkivimit në Republikën e Shqipërisë" ("Metodologjia e Arkivimit"). Metodologjia e Arkivimit përcakton procedurat e detajuara që duhen ndjekur dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore, duke përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, në aktivitetet e tyre të përditshme, si dhe rregullat dhe procedurat në rastet e bashkimit të institucioneve shtetërore.

Në bazë të nenit 23 të Ligjit, NJQV-të duhet të kenë brenda strukturës së tyre organizative një shërbim arkivi. Në varësi të vëllimit të dokumenteve të krijuara, secila NJQV duhet të ketë funksionet e mëposhtme: sekretariati dhe arkiva, sekretari i arkivës apo një punonjës të caktuar për të kryer shërbimin e sekretarit të arkivës.

- Në lidhje me funksionet e arkivimit, çdo NJQV duhet të kryejë:
- Evidentimi i korrespondencës së dërguar apo të pranuar nga ana e NJQV-së
- Procesin e arkivimit, ruajtjes dhe shërbimit të dokumenteve të administruara nga ana e tyre
- Dorëzimin e dokumenteve në arkivat shtetërore, brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

Në përputhje me nenin 43, dokumentet administrative duhet të dorëzohen në arkivat shtetërore përkatëse të përcaktuara nga Ligji me kalimin e 10 viteve nga data e krijimit të tyre.

Në bazë të nenit 44, dokumentet e institucioneve vendore duhet të dorëzohen në Arkivin Shtetëror Vendor drejtpërdrejt nga institucionet të cilat i kanë krijuar.

Kjo do të thotë se çdo NJQV është përgjegjëse individualisht për dorëzimin e dokumenteve në arkivin shtetëror të rrethit përkatës.

Në bazë të nenit 45, kur atributet e një institucioni shtetëror janë transferuar ligjërisht në një institucion tjetër, ky i fundit mund të administrojë dokumentet e trashëguara deri në përfundimin e afateve të parashikuara në nenin 43 të Ligjit. Përveç kësaj, neni 24 i Metodologjisë së arkivimit është gjithashtu i zbatueshëm.

Neni 51 i Ligjit përcakton se, në rast të ndryshimeve në organizimin administrativo-territorial, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ose Arkivi Shtetëror Vendor duhet të njoftohen për të vendosur mbi administrimin e mëtejshëm të dokumenteve.

Qëllimi është mbledhja e të dhënave mbi praktikat e arkivimit për të kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore. Bazuar në këtë, një analizë e praktikave arkivimit do të bëhet dhe do të mund të jepen rekomandime për veprimet përgatitore që do të merren për të lehtësuar transferimin e arkivave në kuadër të amalgamimit të njësisë së qeverisjes vendore ekzistuese në bashkinë e re.

1.5 Të kuptuarit e kërkesave ligjore për menaxhimin e aktiveve

Menaxhimi i aktiveve publike nga njësitë e qeverisjes vendore rregullohet nga Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 2011/12/27, "Për Menaxhimin e Pasurive nga Njësitë Publike". Ky udhëzim është miratuar në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 10.296, datë 2010/08/07, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ligji parashikon përgjegjësinë e Ministrit të Financave për miratimin e udhëzimeve dhe manualeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë publike. Udhëzime të tilla duhet të rregullojnë procedurat standarde për ruajtjen, dokumentimin, qarkullimin, shitjen dhe asgjësimin e aktiveve publike. Përveç kësaj, Ligji përcakton përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të kryetarëve të njësive publike (në këtë rast, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore) në lidhje me menaxhimin e aktiveve publike.

Ligji dhe Udhëzimi i lart-përmendur përcakton gjithashtu përgjegjësinë e Kryetarëve për të miratuar rregulla të veçanta dhe procedurat për mirëmbajtjen,

ruajtjen dhe asgjësimin e aktiveve publike si edhe emërimin e zyrtarit të autorizuar.

Udhëzimi përcakton procedurat e hollësishme për menaxhimin e pasurive si dhe kërkesat specifike për:

- Menaxhimin e riskut të aktiveve
- Regjistrin e aktiveve
- Inventarin e aktiveve

Udhëzimi përcakton ekzistencën e objektivave për përdorimin e aseteve, planeve përkatëse në të cilat janë bazuar objektivat dhe mekanizmat e kontrollit në lidhje me menaxhimin e riskut të aktiveve.

Çdo NJQV duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha pasurive që zotëron ose administron, përfshirë pronat publike që gjenerojnë të ardhura. Nëpunësi autorizues është përgjegjës që të caktojë punonjësin zbatues për krijimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Pasurive.

NJQV-ja gjithashtu duhet të ketë regjistra të ndarë për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare ku NJQV zotëron pjesë (dmth. aksionet e veta) dhe të koncesioneve / kontratave të enfiteozës.

Për sa i përket inventarit të aktiveve publike, Udhëzimi përcakton se inventarizimi bëhet në bazë të përgjegjësive dhe procedurave të miratuara me udhëzim dhe sipas urdhrit / udhëzimit të miratuar nga kryetarët e NJQV-ve.

Çdo NJQV duhet të kryejë inventarizimin e aktiveve në listë një herë në vit, i asistuar nga një komision i posaçëm i përbërë nga të paktën tre anëtarë dhe i krijuar nga Kryetari i NJQV-së ose ndonjë zyrtar i autorizuar i çdo niveli.

Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve kërkon:

- Një komision të posaçëm për vlerësimin e aktiveve, i krijuar me urdhër të kryetarit të bashkisë

Një komision të posaçëm për nxjerrjen jashtë përdorimit të pasurive në përdorim nga ana e NJQV-së, kryetari i të cilit emërohet me urdhër të kryetarit të bashkisë

Në disa raste, kryetari i bashkisë ka të drejtë të krijojë një komision të përbashkët për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë.

1.6 Personalizimi i pyetësorëve për informacion dhe Librit të të dhënave (Databook) operacionale

Përdorni formatin për pyetësorin e paraqitur në Shtojcën 1 dhe të personalizuar për NJQV-në specifike, duke shtuar zëra të rinj në listë ose duke larguar ato ekzistuese.

Në mënyrë të ngjashme përdorni formatet excel të bashkëngjitura në Shtojcën 1 dhe personalizojini nëse është e nevojshme.

1.7 Paraqitja e pyetësorit për informacion dhe Librit të të dhënave (Databook) operacional

Pyetësori për informacion përfshin një listë të detajuar të informacionit që do t'i prezantohet nga NJQV-të ekipit të kontrollit.

Libri i të dhënave operacionale (Databook) janë formate për mbledhje informacioni nga NJQV-të.

Ky aktivitet do të sigurojë që informacioni të mblidhet në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur.

Ekipet duhet të japin udhëzime të hollësishme për mënyrën e ofrimit të informacionit, të kërkojnë paraprakisht informacionet që mund të mungojnë dhe të përpiqen të bien dakord për një plan për përfundimin e mbledhjes së të dhënave.

1.8 Organizimi i vizitave dhe takimeve të planifikuara paraprakisht

Duhet të planifikohen paraprakisht vizita në terren me personelin kryesor në mënyrë që të shihen të gjitha fushat kryesore të mbuluara.

Konsideroni organizimin paraprak të takimeve minimalisht me personelin e mëposhtëm:

- Kryetarin dhe/ose nënkryetarin
- Drejtuesit e të gjitha strukturave administrative të organizimit të NJQV-së
- Personin përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe personin përgjegjës për çështjet ligjore
- Personin përgjegjës për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit
- Personin përgjegjës për arkivimin
- Personat përgjegjës për menaxhimin e aktiveve
- Personat përgjegjës për planifikimin urban
- Personin përgjegjës për shërbimet ligjore

2 Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave

2.1 Organizimi dhe struktura

2.1.1 Strukturat administrative dhe përgjegjësitë

- Merrni rregulloret e brendshme për organizimin e aktiviteteve të administrates së NJQV, të miratuar nga Këshilli i NJQV, për të kuptuar strukturat administrative dhe përgjegjësitë e tyre
- Merrni Vendimin e Këshillit të NJQV "Për miratimin e strukturës organike, numri i punonjësve dhe pagat e administratës të NJQV", për vitin aktual
- Merrni listën e stafit për vitin aktual që përmban informacion për punonjësit si emri i plotë dhe pozicioni që mban
- Rishikoni klasifikimin e strukturës administrative (drejtori kundrejt strukturave më të ulëta) sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave ("VKM") nr.1619, datë 2.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", të ndryshuar me VKM Nr.586, datë 17.7.2013 "Për ndryshimet në VKM nr.1619"
- Kryeni intervista me Kryetarin dhe / ose Nënkryetarin/ët, si dhe drejtuesit e strukturave administrative të NJQV për të kuptuar sa më poshtë:
  - Rolet dhe përgjegjësitë e strukturës përkatëse administrative
  - Numri i të punonjësve nën mbikqyrjen dhe menaxhimin e tij/saj
- Plotësoni formatin në lidhje me "Përshkrimin e përgjegjësive të strukturave administrative" në Shtojcën 3. Identifikoni drejtorinë dhe strukturat administrative përbërëse, numrin e njerëzve dhe përshkrimin e përgjegjësive të strukturave përkatëse. Referoju shembullit për ilustrim:

Shembull:

Drejtoria	Njësia	Numri i punëmarrësve	Përshkrim i funksioneve kryesore të sektorit
Drejtoria e Financës dhe Ndihmës Ekonomike (1)	Financa	3	▪ Hartimi i projekt-buxhetit bashkiak për miratim nga Këshilli Bashkiak dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit; ▪ Llogaritja dhe mbajtja e detyrimeve që rjedhin nga aktivitetet e organizimit dhe të ardhurat e gjeneruara nga burimet e të ardhurave sipas miratimit nga Këshilli i NJQV; ▪ Marrëdhënie me Thesarin: Raportim periodik dhe pajtimi me funksionin e caktuar të thesarit të Ministrisë së Financave; Hartimi i dokumentacionit mbështetës dhe kërkon zyrtarisht në mënyrë periodike rimbursimin e fondeve; ▪ Hartimi dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kërkesat rregullatore të Ministrisë së Financave; ▪ Kontabilizimi i listë-pagesave; ▪ Kryerja e pagesave për të përmbushur detyrimet e Bashkisë.
	Ndihma Ekonomike	1	▪ Administrimi i dosjeve të ndihmës ekonomike duke përfshirë (mbledhjen e informacionit, hartimin e aplikimeve për ndihmë ekonomike, verifikimi i informacionit të kërkuesit në bashkëpunim me institucione të ndryshme si Zyra e Punës, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj); ▪ Bashkëpunon me organizata jo-fitimprurëse dhe humanitare të ndryshme.

- Përgatisni strukturën ekzistuese organizative (nëse nuk është dhënë nga NJQV), dhe vendosni numrin e punonjësve në çdo strukturë administrative. Referohu formatit të përfshirë në “Organizimi dhe Struktura" në Shtojcën 3, dhe shikoni shembullin më poshtë

Shembull:



2.1.2 Disponueshmëria e shërbimeve publike dhe funksioneve horizontale

- Sipas listës së inventarit të të punësuarve dhe intervistave gjysmë të strukturuara, plotësoni të dy formatet: "Disponueshmëria e shërbimeve publike" dhe "Disponueshmëria e funksioneve horizontale" në Shtojcën 3. Formatet e plotësuara do të shfaqin ndarjen e njerëzve në kryerjen e shërbimeve publike dhe funksioneve horizontale në NJQV.

- Shënoni me 'n/a' (‘nuk është e aplikueshme’) numrin e njerëzve në ato funksione ku nuk është bërë alokim personeli. Për njerëzit që kryejnë më shumë se një funksion, të vlerësohet alokimi i përafërt i kohës që personi shpenzon në një funksion të caktuar, duke u nisur nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistave.
- Funksionet të cilat janë të kontraktuara apo të liçensuara janë gjithashtu cilësuar për funksionin përkatës. Për disa prej shërbimeve publike të kontraktuara ose liçensuara, NJQV-ja mund të ketë përcaktuar njerëzit për të monitoruar performancën e palëve së treta. Numri i këtyre njerëzve duhet të pasqyrohet gjithashtu, pranë fjalës "kontraktuar" ose "liçensuar".
- Gjithashtu vini re se numri i njerëzve në strukturat administrative mund të mos përputhet gjithmonë me numrin e njerëzve të alokuar për shërbimet publike dhe funksionet horizontale të përshkruara në tabelat e disponueshmërisë së funksioneve. Dallimet vijnë për shkak të faktit që i njëjti person mund të kryejë më shumë se një funksion.

Shembull:

Shërbimet publike	**Nr. i Njerëzve**
Infrastruktura dhe shërbimet publike	
Ujësjellësi	Kontraktuar
Funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza	4.7
Funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara	4.7
Ndërtimi i rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike	Kontraktuar
Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike	2.2
Ndriçimi i mjediseve publike	1.3

Shembull:

Funksionet horizontale	**Nr. i njerëzve**
Financa	4
Taksat & tarifat vendore	4
Juristi	0.6
Prokurimi	0.2

2.2 Çështjet e personelit

- Merrni "Formatin e inventarit të personelit" nga personi përgjegjës për Burimet Njerëzore. Referojuni dosjes së Librit të të dhënave (Databook) operacionale në Shtojcën 3 për formatin e aplikueshëm për të plotësuar informacionin për personelin e NJQV-ve.
- Sigurohuni për plotësinë dhe saktësinë e informacionit të dhënë në modelin e inventarit të personelit duke:
  - Rishikuar Rregulloren e Brendshme të NJQV-së të aprovuar Nga Këshilli i NJQV-së për vitin aktual dhe vendimin e këtij Këshilli " Për miratimin e strukturës organike, numrit të punonjësve dhe pagave të administrates së NJQV-së" për vitin aktual
  - Intervistuar personin përgjegjës për Burimet Njerëzore në mënyrë që të finalizohet përfundimi i inventarit të personelit të NJQV-së

Shikoni shembullin më poshtë si një ilustrim për të plotësuar formatin e "Inventarit të personelit"

Shembull:

Nr	Emer Mbiemer	Pozicioni i Punes	Njesia	Dita e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi / Kualifikimi	Kategorite e Mbrojtura
13 Anetare Keshilli							
1	XXXX	Kryetar Bashkie		2003	I zgjedhur	Diplome Universitare ne Administrim Biznesi /Diplomë Universitare ne Drejtesi	
2	XXXX	Sekretar Keshilli		2008	Kontrate pune me afat	Shkollë e Mesme	
Financa							
3	XXXX	Shefi i Finances	Sektori i Finances	2003	Kontrate pune me afat	Diplomë Universitare ne Ekonomi /Diplomë Universitare ne Matematike, Fizike	
4	XXXX	Inspektori i Finances dhe Supervizori i Administrimit	Sektori i Finances	2000	Nepunes Civil	Diplomë Universitare ne Ekonomi /Diplomë Universitare ne Matematike, Fizike	Leje mjekesore afat-gjate

2.3 Teknologjia e Informacionit

2.3.1 Inventari i sistemeve të informacionit, hardware-ve dhe kontratave të mirëmbajtjes

Qëllimi i këtij aktiviteti është të inventarizojë sistemet e informacionit të zbatuara në NJQV, hardware të instaluar, licencat e softwareve dhe marrëveshje dhe kontrata të tjera që ekzistojnë, duke përfshirë ofrimin e mirëmbajtjes së softuerit dhe mbështetjen TI, nëpërmjet mjeteve të mëposhtme:

- Marrja e inventarit të plotësuar të sistemeve të TI nga personi përgjegjës për TI
- Intervistimi i personelit të TI për të kuptuar sistemet aktuale të informacionit dhe infrastrukturës së teknologjisë së zbatuar në NJQV. Në rast se NJQV-ja nuk ka personel të TI, intervista mund të kryhet me Kreun e Departamentit të Financave, meqënëse zakonisht ata mbajnë inventarin dhe informacionin për kontratat
- Mbajtja e një inventari për çështjet e mëposhtme:
  - Inventari i personelit IT dhe dhe struktura organizative;
  - sistemet e informacionit të zbatuara në NJQV;
  - marrëveshje licencash për çdo software;
  - kontrata dhe marrëveshje në vend për mirëmbajtjen e software;
  - kategori dhe sasi hardware të tilla si: kompjutera personalë, printera, servera, pajisje fotokopjesh, etj .;
  - kontrata shërbimesh për mirëmbajtjen e hardware-ve.

Referohuni Librit të të dhënave (Databook) operacionale në Shtojcën 3, për formatet përkatëse të përdorura për inventarin e sistemeve të informacionit. Shihni gjithashtu shembullin më poshtë si një ilustrim.

Shembull:

Objektivi	NJQV
Software të instaluar	Paketë Microsoft Programi i kontabilitetit
Kontrata License	
Hardware (ne perdorim)	
Kompjutera (desktop))	XX
Printera	XX
Servera	XX
Të tjera	XX
Personeli IT-së në total	
Mirëmbajtja e hardware	

Shembull:

Software	Versioni	Viti	Licencuar (Po/Jo)	Përdorues të licencuar	Rishitës të Autorizuar	Vërejtje
Microsoft Office	2010	2010	Po	4	PC-STORE	Të instaluara vetëm Microsoft Word dhe Excel
Microsoft Windows	7 Ultimate	2012	Jo	0	Asnje	
Microsoft Windows	Server	2008	Po	1	Infosoft	
Autocad		2008	Jo	0	Asnje	
Kaspersky	Siguria per biznes	2011	Jo	0	Anje	Te instaluar ne te gjithe kompjuterat

Shembull:

Pajisje Hardware	Modeli	Viti	Kontrata e mirembajtje	Mbështetur nga staf i	Rishitës të Autorizuar	Njesi	Vërejtje
UPS	APC	2013	Po	Jo	XYZ	1	Nuk punon sic duhet
Router	Cisco 1921	2014	Jo	Po	ABCD	1	Nuk suporton përdoruesit në komunë
Server	HP Proliant	2012	Jo	Jo	AXYZ	1	Nuk ka ruajtje te informacionit te instaluar
Printer	Xerox Work Centre	2010	Jo	Jo	XYZ	1	Nuk ka mirembajtje
Switch	D-link	2009	Jo	Po	XYZ	3	Nuk i mbulon te gjithe perdoruesit

Shembull:

Staff	Degree	Year of employment	Years of Experience	Role	Training and Certificates	Notes
Arben Dezhurni	Computer Engineering	1	6	Head of IT	Training on Microsoft Office MOS Certificate Cisco CCNA	Maintains also printer Xerox due to lack of outsourced support
Manjola Borshi	Information Systems	3	3	Network Specialist	Cisco CCNA, CCNP	Maintains all networking hardware

2.3.2 Vlerësimi i kontrolleve të TI të zbatuara në sistemet e informacionit dhe të Mjedisit TI

Ky seksion është i zbatueshëm kur sistemet e kontrollit të automatizuar ose gjysmë të automatizuar implementohen në sistemet software të informacionit kontabël apo sisteme software të tjera të menaxhimit të dhënave.

Procedurat që duhet të zbatohen janë:

- Merrni dokumentat e listuara në tekstin bashkëngjitur "Formatet e Kontrollit Operacional", *Shtojca 1 Pyetësori per informacion, seksioni TI*;
- Pas identifikimit të sistemeve informative software kontabël, bashkëpunoni me departamentin e financës të NJQV dhe ekipin përgjegjës për kontrollin, në mënyrë që të identifikoni, në qoftë se sistemi ka zbatuar kontrollin e automatizuar ose gjysmë të automatizuar për përpunimin e të dhënave dhe llogaritje;
- Listoni zbatimin e kontrolleve përkatëse të automatizuara dhe gjysmë të automatizuara;
- Pas verifikimit të ekzistencës së kontrolleve të automatizuar ose gjysmë të automatizuara, rishikoni dokumentet e kërkuara në seksionin "Çështjet e aplikueshme të Kontrollit të Përgjithshëm të IT" të seksionit KPTI ne pyetësorin për informacion si në Shtojcën 1.
- Plotësoni seksionin "*KPTI"* në Shtojcën 3 në mënyrë që të testoni kontrollet e përgjithshme TI;
- Dokumentoni rezultatet e rishikimit të kontrollit të përgjithshëm TI në formatin e paraqitur në seksionin "KPTI" ne Shtojcën 3.

2.3.3 Testimi i kontrolleve të automatizuara rreth menaxhimit financiar të të dhënave dhe gjenerimi i raporteve financiare

Procedurat që duhet të zbatohen janë:

- Merrni listën e kontrolleve përkatëse të automatizuar ose gjysmë të automatizuar të zbatuara;
- Në rast se nuk ka kontrolle të automatizuara ky aktivitet nuk është i zbatueshëm për raportin;
- Përgatisni dhe kryeni procedurat e duhura për shqyrtim per t'u siguruar për hartimin dhe operimin efektiv të kontrolleve të automatizuara dhe /ose gjysëm të automatizuara.

2.4 Sistemet e komunikimit

2.4.1 Inventari i telefonisë dhe marrëveshjeve të internetit që ekzistojnë në NJQV

- Merrni një liste të plotë në lidhje me telefoninë dhe internetin e përdorur nga NJQV-ja
- Nëpërmjet intervistës me personelin TI ose drejtorin e financave identifikoni ofruesit e shërbimeve të telefonisë dhe të internetit.
- Ndërtoni një liste të ofruesve të shërbimeve të telefonisë dhe shërbimeve të internetit për NJQV.
- Vlerësoni mbulimin gjeografik të shërbimit të telefonisë për çdo NJQV (mbulim lokal apo kombëtar).
- Merrni kontratat me ofruesit e shërbimeve të telefonisë dhe të internetit.
- Plotësoni modelin "Përmbledhja e sistemeve të komunikimit" siç tregohet më poshtë

Shembull:

Objektivi	NJQV
Shërbim telefonik	Linje fikse/celular
Operatori i sherbimit telefonik per NJQV-ne	ofrues kombetar
Sherbim interneti	ofrues lokal i internetit
Të vlerësohet mbulimi mbi telefoninë si shërbim për çdo NJQV	mbulim lokal
Mënyrat e brendshme të komunikimit	verbale/ne kopje fizike

2.4.2 Të kuptuarit e metodave të komunikimit të brendshëm të aplikuara në NJQV-të që janë objekt pune (d.m.th mjetet e komunikimit, memo formale protokollare, email-e etj)

Nëpërmjet intervistës me drejtorin e Financave/Shërbimeve ligjore,/personelin TI të kuptojmë metodat aktuale të komunikimit të brendshëm

Shembull:

Objektivi	NJQV
Shërbim telefonik	Linje fikse/celular
Operatori i sherbimit telefonik per NJQV-ne	ofrues kombetar
Sherbim interneti	ofrues lokal i internetit
Të vlerësohet mbulimi mbi telefoninë si shërbim për çdo NJQV	mbulim lokal
Mënyrat e brendshme të komunikimit	verbale/ne kopje fizike

Shembull:

Subjekti	Numri i zyrave që kanë akses:	Numri i zyrave qe kane nevojë për akses:	Bandëidth	Tipi	ofruesi	Kontrata	Vërejtje
Internet	8	15	4 Mbps	DSL	XYZ	1 VIT	Nuk ekzistojne linjat e back-up-it
Telefon	4	19	Një linje	Copper	Albtelecom	Pa limit	Faturat e telefonit janë shumë të larta
Internet	8	15	4 Mbps	Fiber	XYZ	1 VIT	Ekzistojne linjat e back-up-it
Telefon	4	19	Një linje	VoIP	XYZ	1 VIT	

2.5 Arkivimi

- Shtrirja e kontrollit - Shtrirja e kontrollit duhet të jetë sa më e gjerë të jetë e mundur, pa sakrifikuar efikasitetin. Megjithatë, ekziston një kufi për numrin e pozicioneve që një person në mënyrë efektive mund të kryejë. Shtrirja e kontrollit duhet të sigurojë monitorimin e duhur të performancës dhe qasjen ndaj pikëpamjeve të punonjësve (një person përgjithësisht duhet të menaxhojë jo më shumë se 10 punonjës)
- Specializimi: aktivitetet për të cilat është përgjegjës një individ i vetëm duhet të jenë të ngjashme. Funksione të ngjashme duhet të grupohen në

mënyrë të përshtatshme rreth kompetencave kryesore dhe linjave të raportimit

- Shtresat e mbikëqyrjes: numri i niveleve të autoritetit duhet të mbahet në minimum (nga lart poshtë)
- Vendimmarrja: formimi organizativ duhet të lehtësojë vendimmarrje efektive dhe në kohë, në mbështetje të punëve të përditshme
- Komunikimi: komunikimi është efektiv dhe efikas në linjat e raportimit dhe në dhënien e shërbimeve
- Përqasja në koordinim - E aplikueshme sidomos për Administratorët e rinj të cilët do të jenë përgjegjës për drejtimin e njësive rajonale përbrenda drejtorive të ndryshme të shërbimeve publike dhe horizontale. Rregulla dhe procedura të qarta duhen zhvilluar për të bërë dallimin ndërmjet përgjegjsive sektoriale (funksionale) dhe administrative si dhe linjave të raportimit.
- Ndarja hapësinore - formimi organizativ i Bashkise se Re duhet që të pasqyrojë statusin e veçantë dhe të ndërvarur të njësive administrative rajonale (veprime të veçuara në vende të veçuara).
- Rritje dhe ndryshim në të ardhmen - Struktura organizative duhet të jetë fleksibël dhe e adaptueshme ndaj rritjes së ardhshme dhe nevojave për shërbimit publik

4.2 Çështjet e personelit

- Hartoni një përmbledhje te analizës mbi personelin e bashkisë së re të bazuar në analizën e dhënë për çdo NJQV ekzistuese. Kjo analizë duhet të përmbajë informacion mbi numrin e përgjithshëm të personelit, llojin e marrëdhënieve të punës me personelin duke përshkruar numrin e përgjithshëm të nëpunësve civilë, duke përfshirë specifikimet në lidhje me nëpunësit civilë në periudhë prove dhe punëmarrësit. Paraqitni një përmbledhje për çështje specifike të tilla si lloji i kontratave të përdorura për punëmarrësit, numrin përkatës, kategoritë e mbrojtura e të punëmarrësve etj
- Vendosni katër formatet e "Inventarit të personelit" si Shtojcë të raportit të konsoliduar.

4.3 Teknologjia e informacionit

- Vendosni formatin e konsoliduar të "Inventarit të sistemeve të biznesit të TI Referohuni “Formateve të Kontrollit të konsoliduar Operacional” në Shtojcën 3, për formatin përkatës të përdorur për "Inventarin e sistemeve të informacionit" të konsoliduar. Shih gjithashtu shembullin më poshtë si një ilustrim.
- Hartoni një përmbledhje të analizës mbi sistemet e biznesit TI të Bashkisë së re në bazë të informacioneve dhe analizave për çdo NJQV ekzistuese

Shembull:

Objektivi	Ura Vajgurore	Poshnje	Cukalat	Kutalli
Software	Paketa Microsoft	Paketa Microsoft	Paketa Microsoft	Paketa Microsoft
Marreveshje licensash	jo	jo	jo	jo
Harduare (ne perdorim)				
Kompjutyera (desktop)	15	10	2	12
printera	15	10	4	7
Servera	0	2		0
Shefi i personelit te TI	1	0	0	0
Mirembajtja e harduereve	I jashtem/Nga Janari 2015 punesuar personel TI	Ofrues sherbimi i jashtem	Ofrues sherbimi i jashtem	Ofrues sherbimi i jashtem

4.4 Komunikimi

- Hartoni një inventar të përmbledhur të metodave të komunikimit të brendshëm të zbatuara në njësitë e qeverisjes vendore në bazë të informacionit të mbledhur.
- Hartoni një përmbledhje të vëzhgimeve dhe rekomandimeve përkatëse në kuadër të konsolidimit.

Shembull:

Objektivi	Ura Vajgurore	Poshnje	Cukalat	Kutalli
Sherbim telefonik	Telefoni fikse/celulare	Telefoni fikse/celulare	Vetem linje celulare	Vetem linje celulare
Ofrues sherbimi telefonik per NJQV	Ofrues kombetar sherbimi	Ofrues kombetar sherbimi	n/a	n/a
Sherbim interneti	Ofrues sherbimi internet komb etar (Albtelekom)	Ofrues vendor	Ofrues vendor	Ofrues vendor
Mbulim i sherbimit telefonik per cdo NJQV	n/a	n/a	n/a	n/a
Linja te brendshme komunikimi	Verbale/ e shkruar	Verbale/ e shkruar	Verbale/ e shkruar	Verbale/ e shkruar

4.5 Arkiva

- Hartoni një përmbledhje të analizës mbi praktikat e arkivimit bazuar në analizën për çdo NJQV ekzistuese.
- Vendosni në raportin e konsoliduar "Listën e kontrollit të kërkesave teknike" nën përmbledhje. Referohuni “Formateve të Kontrollit të Konsoliduar Operacional” në Shtojcën 3, për formatin përkatës të përdorur në "Lista e kontrollit të kërkesave teknike" të konsoliduar. Shih gjithashtu shembullin më poshtë si një ilustrim.
- Hartoni një përmbledhje të vëzhgimeve dhe rekomandimeve përkatëse në kuadrin e konsolidimit, në tabelën poshtë në faqe.

Kërkesa teknike për praktikat në ambientet e arkivës dhe metodologjinë e mbajtjes së dokumentacionit	**Ura Vajgurore**	**Poshnje**	**Kutalli**	**Cukalat**
Mbrojtja kundër zjarrit, mbulesa për mbrojte nga dielli, pluhuri, dhe ndonjë agjenti tjetër fizik dhe biologjik	Po	Jo	Jo	Jo
Dyer të siguruara dhe dritare me rrjete metalike dhe mbyllje automatike e dyerve	Jo	Jo	Jo	Jo
Mbulesa kartoni për vendosjen e dokumenteve, të vendosura në rafte metalike dhe të lyera kundër ndryshkut	Po	Po	Jo	Jo
Rafte vertikale të orientuara nga dritaret me një distance 40-60 cm nga muri dhe 80 cm nga njëra tjetra	Po, por pa distancë nga muri	Po, por pa distancë nga muri	Jo	Jo
Prezenca e ngrohëseve që mund të shkaktojnë zjarr në ambientet e arkivimit	Jo	Po	n/a	Jo
Gjurme auditi për kontroll fizik mbi arkivat, që duhet të mbahet nga sekretariati i arkivës	Po	Po	Jo	Jo
2 kopje çelësash për arkivën	Po	Jo	Jo	Jo

4.6 Menaxhimi i aktiveve

- Hartoni një përmbledhje të analizës mbi praktikat e arkivimit bazuar në analizën për çdo NJQV ekzistuese.
- Vendosni në raport "Listën e kontrollit të kërkesave për menaxhimin e aktiveve" të konsoliduar nën përmbledhje. Referohuni “Formateve të Kontrollit të Konsoliduar Operacional” në Shtojcën 3, për formatin përkatës të përdorur në "Lista e kontrollit të kërkesave për menaxhimin e aktiveve" të konsoliduar.
- Hartoni një përmbledhje të vëzhgimeve dhe rekomandimeve, ne kuadër te konsolidimit

4.7 Projektet e Investimeve

- Vendosni tabelën e konsoliduar të "Projekteve të Investimeve”. Referohuni dosjes së “Formateve të Kontrollit të Konsoliduar Operacional” në Shtojcën 3, përformatin përkatës të përdorur në "Projektet e Investimeve" të konsoliduar.

4.8 Çështjet ligjore

4.8.1 Kontratat e shërbimeve publike

- Vendosni tabelën e konsoliduar të "Kontratave të shërbimeve publike".

4.8.2 Procedurat ligjore

- Vendosni tabelën e konsoliduar të “Çështjeve Gjyqësore”.

4.8.3 Kontratat me palë të treta

- Vendosni tabelën e konsoliduar të “Kontratave me palët e treta”.

Kontrolli financiar

Kontrolli financiar

Një pamje e përgjithshme e proçesit të kontrollit financiar dhe aktiviteteve kryesore që do të ndiqen gjate çdo hapi janë të paraqitura më poshtë.

Me një klikim mbi ikone ju mund të shkoni tek seksioni përkatës.

Planifikimi

- Njihuni me Kuadrin Raportues
- Përshtatni *Pyetësorin për informacion* dhe *Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare* për NJQV-në
- Dorëzoni NJQV-së *Pyetësorin për informacion* duke përfshirë formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare
- Organizoni vizitat në terren dhe programoni takimet paraprakisht

Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave

- Mblidhini të dhënat sipas Pyetësorit për informacion dhe sigurohuni për plotësinë dhe saktësinë e tyre
- Sigurohuni për kryerjen e proçedurave të përshkruara për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet

Analiza dhe përgatitja për konsolidim

- Përgatisni pasqyrat financiare më vehte për çdo NJQV duke u bazuar në të dhënat e mbledhura
- Hidhini të dhënat në Modelin Financiar
- Kryeni rregullime kontabël, reflektojini në shifrat e riparaqitura dhe kontrollojini për koherencë
- Analizoni pasqyrat financiare
- Përgatisni dokumentet për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve

Konsolidimi

- Përmblidhni regjistrat e aktiveve të qëndrueshëm dhe vazhdoni me vlerësimin
- Pasqyroni rezultatet e vlerësimit në pasqyrat financiare më vehte dhe në Modelin financiar
- Plotësimi i modelit të konsoliduar financiar
- Analizimi i gjëndjes së konsoliduar financiare
- Tregoni rreziqet e mundshme për bashkinë e re pas bashkimit

5 Planifikimi

5.1 Njihuni me kuadrin raportues

Kuadri raportues është krijuar në vijim të një rishikimi të legjislacionit në fuqi në lidhje me raportimin:

- Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008, 'Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë',
- Udhëzimi 29 datë 24.12.2013 "Për procedurat e mbylljes së buxhetit për vitin 2013", dhe
- Udhëzimi Nr.14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore të të gjitha niveleve".
- Udhëzimi Nr.26 datë 26.12.2007 mbi disa ndryshime ndaj Udhëzimit Nr.14 datë 28.12.2006
- Udhëzimi 28 datë 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014".

Lexoni dhe njihuni me ligjin dhe udhëzimet e përmendura më sipër.

5.2 Përshtatni Pyetësorin për informacion dhe Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare për NJQV-në

Përdorni *Pyetësorin për informacion* të paraqitur në Shtojcën 1 dhe përshtateni me NJQV-në përkatëse.

Në mënyre të ngjashme, përdorni *Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare* të paraqitura në Shtojcën 6 dhe përshtatini nëse është e nevojshme.

5.3 Dorëzoni Pyetësorin për informacion duke përfshire Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare

Pyetësori për informacion, i përfshire në Shtojcën 1, përmban një listë të detajuar informacionesh për tju paraqitur grupit të kontrollit nga NJQV-ja.

Formatet për Shënime mbi pasqyrat financiare, të përfshira *në Shtojcën* 6, janë formate të paplotësuara, për t'u përdorur nga NJQV-ja për paraqitjen e informacionit financiar në po të njëjtin format.

Kjo veprimtari do të siguronte që informacioni të mblidhej në mënyre efikase dhe në kohën e duhur.

Grupet duhet të ofrojnë udhëzime të detajuara rreth mënyrës sesi informacioni pritet të dorëzohet, të pyesin paraprakisht për mungesë të mundshme informacioni dhe të tentojne të bien dakord mbi një afat kohor për përfundimin e mbledhjes së të dhënave.

5.4 Organizoni vizitat në terren dhe programoni takimet paraprakisht

Vizitat në terren me personelin kryesor duhet të planifikohen paraprakisht, në mënyrë që të shihen të gjitha fushat kyçe të mbuluara.

Konsideroni të programoni paraprakisht takimet, gjatë së cilave të jetë prezent minimalisht personeli i mëposhtëm:

- Kryetari dhe Nënkryetari i Bashkisë
- Kreu i Drejtorisë se Financës dhe të tjerë personel nga Financa
- Kreu i Drejtorisë për Mbledhjen e të Ardhurave
- Personi përgjegjës për buxhetin
- Personi përgjegjës për aktivet, nëse është i disponueshëm
- Përfaqësues nga Urbanizimi rreth projekteve në proçes

6 Puna në terren dhe mbledhja e të dhënave

6.1 Mblidhini të dhënat sipas *Pyetësorit për informacion* dhe sigurohuni për plotësinë dhe saktësinë e tyre

Në ketë fazë, grupi duhet të zhvillojë vizita në terren dhe të marrë pjesë në takimet e programuara me personelin kryesor. Grupi duhet të sigurohet edhe njëherë që personeli i NJQV-së i kupton të gjitha kërkesat sipas *Shtojcës 1: Pyetësor për informacion.*

Mblidhni të dhënat sipas Shtojcës 1: *Pyetësor për informacion* dhe sigurohuni që të dhënat e paraqitura janë të plota dhe të sakta.

Duke u bazuar në informacionin e mbledhur, grupi duhet të kryejë analizën dhe proçedurat sikur është shpjeguar në seksionet në vijim.

6.2 Kryeni procedurat e përshkruara për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet

Më poshtë paraqitet një listë e proçedurave të sugjeruara për elementët përkatës të pasqyrave financiare që duhet të konsiderohen gjatë kryerjes së kontrollit për NJQV-të e përzgjedhura.

6.2.1 Buxheti

Merrni buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2015.

Ndermjet intervistave informohuni për të kuptuar proçesin e përgjithshëm të buxhetimit, duke përfshirë pjesëmarrësit në proçes dhe gjithashtu personat që aprovojnë buxhetin.

Merrni një analizë të buxhetit kundrejt aktualit dhe diskutoni e komentoni mbi diferencat.

Merrni rishikimet e buxhetit për vitet 2013 dhe 2014 dhe diskutoni e komentoni mbi arsyet e këtyre rishikimeve.

Aktivet e qëndrueshme

Ndermjet intervistave informohuni për të kuptuar procedurat aktuale dhe komentoni rreth përputhshmërisë me kërkesat e diktuara nga ligji.

Siguroni çdo proçedurë të shkruar për regjistrimin, mbajtjen, mirëmbajtjen dhe kryerjen e inventarit të aktiveve të qëndrueshme.

Pyesni personin përgjegjës për politikën e vlerësimit dhe amortizimit, dhe testimet për zhvlerësim.

Pyesni personin përgjegjës rreth dokumenteve mbështetës për aktivet e qëndrueshme të regjistruara p.sh. nëse aktivet më kryesore janë të mbështetura me dokumentacion të përshtatshëm, vendin ku mbahet dokumentacioni dhe etj.

Informohuni nëse NJQV-ja kryen numërime inventari vjetore (ose të tjera periodike) të aktiveve të qëndrueshme dhe siguroni raportet për numërimet e inventarit për vitin 2014.

Siguroni listën e aktiveve të qëndrueshme që janë transferuar nga qeveria qëndrore, siguroni dokumentacionin mbështetës përkatës për këto aktive.

Siguroni regjistrin e plotësuar të aktiveve të qëndrueshme (formati përfshihet në *Shtojcën 1: Pyetësor për informacion*).

Kontrolloni politikën e aplikuar të amortizimit (pyesni dhe ri-llogarisni) dhe komentoni nëse janë aplikuar jetëgjatësitë e duhura.

Rakordoni shtesat për kosto dhe amortizim gjatë vitit me informacionin në F4, F8, and Sh12.

6.2.2 Inventari

Merrni formatin e plotësuar Sh2 Lista e inventarit (N2 List of inventory), që i është dhënë NJQV-së së bashku me Shtojcën 6: Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare (Appendix 6: Templates for Notes to the financial statements).

Rakordoni balancën sipas Sh2 Lista e inventarit të plotësuar dhe balancave të inventarit të paraqitura në F1 Pasqyra e Aktiveve (F1 Statement of Assets). Kuptoni dhe komentoni mbi diferencat.

Rakordoni shtimin/ (pakësimin) në inventar gjatë vitit me llogarinë 841 ose 842 në F*3-1/2*

Rakordoni shtimin/ (pakësimin) në inventar gjatë vitit me *T8.*

6.2.3 Debitorët dhe të tjera të arkëtueshme

Siguroni listën e detajuar të debitorëve siç parashikohet në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare (Appendix 6: Templates for Notes to the financial statements).*

Rakordoni informacionin e siguruar me Sh3 *Të arkëtueshme nga Punonjësit*, parapagesa dhe gjoba (*N3 Receivables from Employees, prepayments and penalties*) dhe *Sh4 Debitorë t*ë *ndryshëm (N4 Different debtors).*

Rakordoni listën e detajuar me listë llogarinë / librat kontabël dhe pasqyrat financiare.

Analizoni përmbajtjen dhe strukturën e këtyre llogarive, përshkruani elementet më kryesorë dhe komentoni mbi politikën kontabël dhe përputhshmërinë me ligjet përkatëse.

6.2.4 Balanca e parasë së gatshme

Siguroni aktin e trashëgimisë të përgatitur nga NJQV-a sipas *Sh5 Akti i Trashëgimisë (N5 Inheritance Act) i Shtojcës 6: Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare*.

6.2.5 Kreditorët, kreditë dhe huazimet

Siguroni listën e detajuar të kreditoreve të paraqitur në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare,* të dhënë NJQV-së së bashku me *Pyetësorin për Informacion* , e cila duhet të përfshije një listë të të gjitha faturave të marra nga NJQV-ja, të cilat nuk janë paguar dhe /ose nuk janë regjistruar (deri në datën më të fundit të disponueshme).

Kërkojini NJQV-së të identifikojë pagesat e vonuara duke analizuar të dhënat e faturave dhe të pagesave dhe vleresoni penalitetet e nevojshme.

Siguroni detajizimin e të gjitha kredive dhe huazimeve, duke përfshire detajet e paraqitura në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare,* të dorëzuar NJQV-së.

Kërkoni një plan ripagimi për të gjitha kreditë, huazimet dhe qiratë (deri në datën më të vonë të disponueshme).

Kërkoni një listë të të gjithë projekteve "aktive" – për të cilat proçedura e tenderimit ka përfunduar, janë në proçes, dhe jo të gjitha detyrimet janë shlyer (deri në datën më të vonë të disponueshme).

Analizoni detyrimet për 2014 dhe duke u bazuar në rishikimin e proçeseve dhe në intervistat me personat përgjegjës, kuptoni nëse ka detyrime të cilat nuk janë regjistruar.

Duke u bazuar në kontratën për hua dhe qera, kuptoni nëse ka detyrime të cilat nuk janë regjistruar.

Duke u bazuar në analizën e detyrimeve kuptoni klasifikimin e kontratave afatshkurtër e afatgjatë. Në rast se nuk ka të tillë klasifikim, propozoni proçedurat për klasifikim të detyrimeve në afatshkurtër dhe afatgjatë.

Rakordoni kreditorët me informacionin në *Sh12 Rakordime t*ë *PF me Thesarin (N12 Reconciliation of FS with Treasury*).

6.2.6 Shpenzime

Siguroni rakordigmet mujore (kumulative) me Thesarin për fundin e vitit 2014, siç paraqitet në *Sh7 Rakordimi i Shpenzimeve*, i përfshire në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare.*

Kontrolloni nëse rakordimet janë rishikuar dhe aprovuar në mënyrën e duhur.

Diskutoni rreth diferencave të identifikuara gjatë rakordimeve me përfaqësuesit e NJQV-së dhe të Departamentit Rajonal të Thesarit.

Rakordoni detajimin e shpenzimeve sipas rakordimit me Thesarin me listë llogarinë / librat kontabël dhe Pasqyrat financiare.

Analizoni shpenzimet më kryesore (duke përfshire strukturën/përmbajtjen e tyre).

Rakordoni *Sh12 Rakordimi i PF me Thesarin (N12 Reconciliation of FS with Treasury).*

6.2.7 Të ardhurat

Siguroni rakordimet mujore (kumulative) me Thesarin për fundin e vitit 2014, të përgatitur nga NJQV-ja sipas kërkesave në *Sh8 Rakordimi i t*ë *ardhurave (N8 Revenue reconciliation)*, të përfshire në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare.*

Kontrolloni nëse rakordimet janë rishikuar dhe aprovuar në mënyrën e duhur.

Diskutoni rreth diferencave të identifikuara gjatë rakordimeve me përfaqësuesit e NJQV-së dhe të Departamentit Rajonal të Thesarit

Rakordoni detajimin e të ardhurave sipas rakordimit me Thesarin me listë llogarinë / librat kontabël dhe Pasqyrat financiare.

6.2.8 Investimet në filiale

Siguroni formatin e plotësuar për Investime në filiale, të bashkangjitur Shtojcës 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare.*

Rakordoni detajimin e paraqitur në format, me listë llogarinë / librat kontabël dhe Pasqyrat financiare.

6.2.9 Grantet nga donatorë të huaj

Siguroni një detajim të granteve nga donatorë të huaj, të përgatitur nga NJQV-ja sipas *Sh11 Grante nga donatorë (N11 Donor Grants)*, të përfshire në Shtojcën 6: *Formate për Shënime mbi Pasqyrat financiare.*

Rakordoni detajimin e paraqitur në format, me listë llogarinë / librat kontabël dhe Pasqyrat financiare.

Analizoni dhe komentoni politikat kontabël dhe perputhshmërinë me udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Rakordoni grantet kapitale me paqyrat e prezentuara në formatet *F4 dhe F8,* ndërsa grantet korente nga donatorët e huaj me formatin F3/2.

7 Analizë dhe përgatitje për konsolidim

7.1 Siguroni pasqyrat financiare individuale për çdo NJQV duke u bazuar në të dhënat e mbledhura

Siguroni pasqyrat financiare përfundimtare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014, në format elektronik dhe në kopje fizike.

Siguroni listë llogaritë dhe rakordojini me pasqyrat financiare për 2014 (nëse janë të disponueshme).

Krahasoni dhe sigurohuni që versioni elektronik të jetë i njëjte me atë të nënshkruar nga NJQV-ja dhe përfaqësuesit e Thesarit.

Analizoni përbërjen e pasqyrave financiare (cilat raportet dhe pasqyra janë përfshire si pjesë e pasqyrave financiare) dhe kontrolloni nëse është në përputhje me formatin financiar të përshkruar nga Ministria e Financës.

Ndermjet intervistave kuptoni se në bazë të cilave dokumentave janë përgatitur pasqyrat financiare (listë llogaritë, raporte të tjera në excel, librat kontabël etj.)

7.2 Hidhini të dhënat në Modelin Financiar

Në këtë seksion të dhënat e siguruara nga NJQV-ja do të hidhen në Modelin Financiar për të lehtësuar analizën dhe raportimin, dhe për të vënë në dukje gabime në rakordim dhe pjesë që kërkojnë hetime të mëtejshme.

Modeli financiar është një mjet i bazuar në excel që ka për qëllim lehtësimin e mbledhjes së të dhënave, rakordimit dhe raportimit për qëllim të kontrollit financiar. Modeli përmban tabela të formatuara për raportimin e Pasqyrave financiare dhe Shënimeve mbi Pasqyrat Financiare. Gjithashtu, është përgatitur dhe një rakordim automatik për të kontrolluar përputhshmërinë e informacionit nga burime të ndryshme të të dhënave, si psh. Pasqyrat financiare, Shënime mbi Pasqyrat financiare, ose evidenca të tjera të marra. Pas përfundimit të marrjes së të dhënave, grupi i punës duhet të përgatisë rregullimet kontabël (sistemimet nëse ka) dhe t'i reflektojë ato në Pasqyrat financiare qe ndikohen prej tyre.

Me pëjashtim të rregullimeve, të gjitha qelizat ku hidhen të dhënat në faqet e PF të NJQV (Formatet) (LGU's FS (Template), Shënimeve 1 deri në 12 dhe faqet ku hidhen të dhënat në seksionin e Evidencës së marrë, janë ngjyrosur me të verdhë për të lehtësuar përdoruesin në plotësimin e të dhënave në qelizat e duhura. Një përmbledhje e përshkrimit të faqeve dhe përmbajtjes së Modelit Financiar janë paraqitur në *Shtojcën 10: Përshkrimi i përmbajtjes së Modelit Financiar*.

Një përmbledhje mbi rrjedhën e informacionit në Modelin Financiar është paraqitur më poshtë:



7.2.1 Hedhja e të dhënave në Faqet e Informacionit të Përgjithshëm dhe të Formave të Pasqyrave financiare

7.2.2 Informacioni i përgjithshëm

Në ketë seksion, përdoruesi duhet të hedhë informacion vetëm në qelizat e Verdha (Kolona H). Në seksionin 1.1 *Informacion i përgjithshëm (General information)* i Modelit financiar, janë përfshire emri i Projektit, emri i NJQV-së subjekt i kontrollit, emrat e personave që përgatisin listën e informacionit, emri i aprovuesit dhe data e aprovimit për qëllime të menaxhimit të projektit. Emri i NJQV-së i vendosur në ketë seksion do të plotësohet automatikisht në tabelat raportuese, si edhe në seksionet e tjera të modelit.

Shembull:



Seksioni 1.1. *Informacion i përgjithshëm i Modelit financiar* vijohet nga qeliza ku plotësohen të dhënat për datat e vizitave në terren (Seksioni 1.2 Vizita në terren).

Seksioni 1.3 *Personeli i intervistuar* (*1.3 Interviewed personnel*) plotësohet me emrat e personave të intervistuar gjatë vizitave tek NJQV-ja.

Shembull:



.

Në seksionin *1.4 Periudhat financiare (1.4 Financial periods)* hidhen datat e raportimit të informacionit financiar të paraqitur në raportin e Kontrollit. Në qelizën *H63* duhet të përfshihet data e raportimit të periudhës aktuale të raportimit, ndërsa në *H64* duhet të përfshihet data e fillimit të periudhës raportuese aktuale d.m.th. 30 qershor 2015 dhe 1 janar 2015 nëse periudha e raportimit është në 6 muajt e parë të 2015.

Në qelizën *H66* duhet të përfshihet data e raportimit të periudhës raportuese paraardhëse, për shembull 31 dhjetori 2014, në vijim të shembullit të mësipërm.

Në Seksionin *1.5 Prezantimi* (*1.5 Presentation*), valuta raportuese duhet të zgjidhet, d.m.th në mijëra, miliona, miliarda, duke hedhur numrin përkatës në qelizën *H70* – për shembull, hidhni 1000 nëse doni t'i paraqisni të dhënat në mijëra ose 1000000, në rast se doni t'i paraqisni në miliona.

Shembull:



7.2.3 Transferoni të dhënat në formatin e Pasqyrave financiare

Shkoni tek faqja e *PF të NJQV (Formatet)* (*LGU's FS (Template).* Në këtë faqe hidhen të dhënat e siguruara nga Formati i Pasqyrave Financiare të marrë nga NJQV-ja. Të dhënat plotësohen në kutitë e verdha boshe, në kolonat E deri në N, në varësi të Formateve. Përdoruesi nuk duhet të shtoje ose të fshije ndonjë kolonë ose rresht, ose të rregulloje qeliza te veçanta të cilat përmbajnë të dhënat aktuale, d.m.th. emrat, periudhat, numrat kontabël, qeliza që përmbajnë formulat, etj.

Shembull:

	A	B	C	E	F
1	**Template nr. 1**				
2			**ASSETS 2014**		*(in ALL)*
3	**Nr.**	**Account number**	**EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT**	**Closed exercise**	**Previous exercise**
4					
5	**1**	**12**	**Rezultate te mbartura(saldo debitore)**		
6	**2**	**A**	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	-	-
7	**3**	**20, 230**	**I.Te pa trupezuara**	-	-
8	4	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave		
9	5	202	Studime dhe kerkime		
10	6	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme		
11	7	209	Amortizimi i aktiveve qendrushme te pa trupezuara(-)		
12	8	230	Shpenzime per rritjen e aktiv.qendr.patrupezuara		
13	**9**	**21,23,24.28**	**II.Akt.Qendr.te Trupezuara**	-	-
14	10	210	Toka,troje,Terene		
15	11	211	Pyje,Kullota Plantacione		
16	12	212	Ndertime e Konstruksione		
17	13	213	Rruge,rrjete,vepra ujore		
18	14	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune		
19	15	215	Mjete transporti		
20	16	216	Rezerva shtetrore		
21	17	217	Kafshe pune e prodhimi		
22	18	218	Inventar ekonomik		
23	19	219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)		
24	20	231	Shpenzime proces per rritjen e AQT		

7.2.4 Transferoni të dhënat në evidencën e marrë

Në vijim të faqes *PF të NJQV (Formatet)* (*LGU's FS (Template),* në të djathtë gjeni faqet e mbetura ku duhen hedhur kopjet e dokumentacionit mbështetës, që mund të jenë direkt të marra nga exceli ose kopje të skanuara në PDF.

7.2.4.1 Përdorimi i mjetit për rakordim automatik

Disa faqe kanë si pjesë përbërëse një funksion automatik i cili lejon rakordimin automatik ndërmjet elementëve specifikë dhe pasqyrave financiare (referojuni faqes *Kontrolle (Checks*). Për ta përdorur, thjesht postoni (Paste) ekstraktet siç janë marrë nga klienti ose shkruani në një qelizë vlerën totale sipas dokumentacionit mbështetës, selektoni qelizën me vlerën totale për t'u rakorduar dhe klikoni butonin gri (i cili përmban udhëzimin) në krye të faqes. Shuma e selektuar duhet të shfaqet automatikisht në rakordimin përkatës në faqen *Kontrolle (Checks)*

Shembull:



7.2.5 Plotësimi i Shënimeve mbi Pasqyrat financiare

Shënimet përgatiten për të paraqitur detaje të mëtejshme rreth seksioneve kryesore të pasqyrave financiare. Shënimet duhet të paraqiten së bashku me *Shtojcën 1: Pyetësori për informacion*, i cili duhet të plotësohet nga përfaqësuesit e NJQV-së.

Siç merren, Shënimet mbi Pasqyrat financiare, d.m.th. *faqet Sh1-Sh13*, transferohen në model manualisht. Për përshkrimin dhe metodologjinë rreth mënyrës së transferimit të Shënimeve mbi Pasqyrat financiare në Modelin Financiar, referojuni seksionit 3.3.

7.2.6 Kontrolli për Pasqyrat financiare

7.2.6.1 Përshkrimi i përgjithshëm

Faqja *e Kontrolleve (Checks)* është e paraprogramuar për rakordim midis tabelave në faqet *F1-F11*, Shënimeve mbi Pasqyrat financiare në Faqet *Sh1-Sh13* dhe dokumentacionit mbështetës në seksionin e Evidencës së marrë në këtë model. Rakordimet e paraprogramuara do t'i shërbenin përdoruesit si udhëzues i përgjithshëm për rastet kur ekzistojnë deklarime të pasakta dhe do ta ndihmonin përdoruesin në identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve. Duhet të theksohet që disa gabime mund të vijnë falë të dhënave të pasakta të dhëna nga NJQV-ja dhe nuk lidhen domosdoshmërisht me plotësimin e pasaktë të modelit financiar.

Përdoruesi nuk duhet të modifikojë rakordimet brenda ne listë.

Udhëzime mbi kontrollet e Pasqyrave financiare

Në këtë seksion përdoruesi do të vlerësojë nëse informacioni është transferuar në mënyre korrekte nga formatet e pasqyrave financiare të NJQV-së tek Modeli.

Meqenëse Modeli i lejon përdoruesit të kryejë kontroll automatik në varësi të disponueshmërisë së informacionit, hapi i parë në përdorimin e kontrolleve automatike do të ishte caktimi i datës së raportimit. Në rast se përdoruesi siguron informacion për 2014 në Format 1 deri në 3, por informacioni ne tabeleta e tjera (F4 deri F9) eshte plotesuar me me informacion e periudhës raportuese paraardhëse, p.sh. viti financiar 2013, atëherë rakordimet e para do të ishin për vitin financiar 2013. Përdoruesi duhet të marrë informacion në shiritin blu në krye të çdo faqeje rreth gabimeve – si "Të gjitha kontrollet jane ok" (All checks ok) ose "Gabim në rakordim" (Reconciliation error).

Shkoni tek faqja e *Kontrolleve (Checks)* dhe vlerësoni nëse data e referencës së dokumentacionit mbështetës është vendosur në mënyre korrekte (Qeliza E7). Për shembull, nëse informacioni në Format 4 deri në 9 dhe Shënimet i referohen periudhës raportuese aktuale, 30 qershor 2015, përdoruesi duhet të shkruajë 30 qershor 2015 në qelizën F7.

Hapi tjetër do të ishte të rishikohej shuma e gabimit në rakordim në Qelizën F9. Edhe nëse gabimi në rakordim është 0, përdoruesi duhet të konfirmojë që shumat e elementeve në kontrollet individuale korrespondojnë me ato në pasqyrat financiare dhe me të dhënat e siguruara nga NJQV-ja. Për shembull, përdoruesi duhet të vrojtojë nëse shuma e totalit të aktiveve të kuotuara në rreshtin 16 korrespondon me vlerën totale në faqen F1 dhe në formatin e Pasqyrave financiare të paraqitura nga NJQV-ja. Kjo praktike duhet të ndiqet për të gjithë elementet për të siguruar një hedhje konsistente të dhënash në model.

Shembull:



7.2.7 Plotësim automatik i formateve të Pasqyrave financiare

Ky seksion shpjegon si kryhet plotësimi automatik i Formave 1-11.

Plotësim automatik i formatit të Pasqyrave financiare

Tabelat në faqet *F1-F11* plotësohen automatikisht me informacionin historik sipas datave të periudhave të raportimit aktual ose paraardhëse. Përdoruesi duhet të konfirmojë vetëm nëse të dhënat janë paraqitur në mënyre korrekte dhe nuk duhet të modifikojë formula ose të hedhë të dhëna në tabela.

Kolonat e riparaqitura, nëse ndodhen në tabela, duhet të plotësohen manualisht me rregullimet (sistemimet)/riparaqitjet e identifikuara. Për më shumë informacion, referojuni Seksionit 3.4. Shënimet mbi Pasqyrat Financiare, d.m.th faqet *Sh1-Sh13* nuk plotësohen automatikisht dhe përdoruesi duhet të plotësoje manualisht informacionin e kërkuar në këto faqe.

Shembull:

Project STAR
XXX
Balance Sheet - Statement of assets (Template 1)
Reconciliation error

XXX
Balance Sheet - Statement of assets (Template 1)
for the year ended 31 Dec 2013
(Amounts in ALL'000, unless otherwise stated)

No	Account Number	Assets	Notes	As at 31 Dec 2014	As at 31 Dec 2013 (Restated)	As at 31 Dec 2013
1	12	**Brought forward results**				
2	A	**Non Current Assets**		-	384,058	384,058
3	20, 230	**I. Intangible Assets**		-	1,315	1,315
4	201	Amounts to be remitted and loan reimbursements		-	-	-
5	202	Studies and research	T6, N1	-	1,672	1,672
6	203	Concessions, license, other similar licenses		-	-	-
7	209	Amortization of current intangible assets (-)	T7, N1	-	(357)	(357)
8	230	Expenses for increase of current intangible assets		-	-	-
9	21,23, 24,28	**II. Tangible Assets**		-	382,743	382,743
10	210	Land		-	-	-
11	211	Forests, Pasture, Plantation	T6, N1	-	3,274	3,274
12	212	Building and Constructions	T6, N1	-	129,362	129,362

7.2.8 Plotësimi automatik i faqes Kontrolle (Checks)

Plotësimi automatik i faqes Kontrolle (Checks)

Faqja Kontrolle (Checks) përgatitet automatikisht kur të gjitha të dhënat hidhen në vendndodhjet përkatëse përbrenda modelit. Ajo duhet të shërbeje si një udhëzues i përgjithshëm mbi plotësine dhe konsistencën e të dhënave të hedhura. Gjithsesi përdoruesi duhet të shqyrtojë në mënyre kritike të gjitha të dhënat e paraqitura për plotësi dhe korrektësi.

Pritet që përdoruesi t'i referohet faqes Kontrolle (Checks) pas përfundimit të çdo faze për të vlerësuar korrektësinë e punës së kryer.

Përdoruesi nuk duhet të modifikojë rakordimemt përbrenda listës.

Shembull:

Project STAR
XXX
Checks
Reconciliation error

		0	1
		31-Dec-14	31-Dec-13
Supporting documentatio	31 Dec 13		
Mastercheck	5,816,601	1,542,866,954	5,816,601
1 Checks - Templates 1-9			
1.1 Balance sheet			
T2		0	472,611,676
T1		0	472,611,676
Check		-	-
Own funds - T8		404,512,150	404,512,150
Net assets - current period - T1-T2		0	404,512,150
Check		*404,512,150*	-
Fixed assets - T6		364,867,356	364,867,356
Depreciation - T7		(58,313,749)	(58,313,749)
Investments - T4		77,504,030	77,504,030
NBV of fixed assets - T1		0	384,057,637
Check		*384,057,637*	-
Treasury funds - T5		15,600,295	15,600,295
Treasury funds - T1		0	15,600,301

7.2.9 Analizoni evidencën e dhënë për të mbështetur plotësinë dhe saktësinë e Pasqyrave Financiare

Ky seksion shpjegon metodologjinë bazë për t'u referuar gjatë analizimit të evidencës të dhënë si pjesë e mbledhjes së të dhënave dhe gjithashtu ofron udhëzime rreth plotësimit të Shënimeve përkatëse dhe lidhjes me shifrat e paraqitura në Pasqyrat financiare të NJQV-së.

Metodologjia e përfshire në ketë seksion bazohet në procedurat e sugjeruara, të përshkruara në seksionin 2.2 dhe vijon kushtet e parashtruara në udhëzimet e mëposhtme të miratuara nga Ministria e Financave ("MF"):

- Udhëzimi Nr.14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore të të gjitha niveleve" (më tej "Udhëzimi Nr. 14").
- Udhëzimi Nr.26 datë 26.12.2007 mbi disa ndryshime ndaj Udhëzimit Nr. 14 datë 28.12.2006. Në bazë të analizës tonë të mbajtjes së kontabilitetit dhe praktikave të mbajtjes së llogarive të Bashkisë, si edhe duke marrë në konsideratë kriteret e mësipërme, kemi propozuar rregullime (sistemime) specifike për pasqyrat financiare të vitit fiskal 2013 (më tej "Udhëzimi 26")

Shënimet e plotësuara të pasqyrave financiare do të kopjohen tek Raporti i Kontrollit të përshkruar në seksionin 4. Referojuni seksionit 3.6 për një udhëzim të detajuar mbi mënyrën e kopjimit të këtyre shënimeve.

7.2.9.1 Sh1 regjistri i aktiveve të qëndrueshme (N1 Fixed assets register)

Shkoni në faqen Sh1. Në varësi të informacionit të siguruar nga NJQV-ja, shtoni aq rreshta midis rreshtave 17 dhe 21 sa të jenë të nevojshëm për të paraqitur të gjitha të dhënat e siguruara. Selektoni rreshtat në krye dhe zgjeroni përzgjedhjen për të përfshire të gjithë rreshtat deri tek rreshti i "Total"-it. Shtypni Ctrl+D për të plotësuar formulat në rreshtat e rinj të shtuar. Të dhënat duhet të plotësohen në kolonat B deri në F, H, në kolonat Q deri në T, dhe në kolonën V. Përdoruesi duhet të konfirmojë që formula e mbledhjes (SUM) në rreshtin e fundit mbledh të gjitha rreshtat që përmbajnë të dhëna në kolonën V.

Ne kolonat *X deri në AA*, paraqiten kategoritë e aktiveve me kodet përkatës, metoda dhe norma përkatëse e amortizimit, të cilat janë të përcaktuara në Udhëzimin Nr.14 të datës 28.12.2006 (referojuni *seksionit II, kapitullit 1, faqes 4, paragrafit 3*).

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordon me pasqyrat financiare. *Faqja Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të vlerës totale të aktiveve të qëndrueshme dhe të balancave të aktiveve të qëndrueshme sipas *faqes F1*.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara paraqiten në kosto tek pasqyrat financiare, *Forma 1 Pasqyra e aktiveve (Form 1 Statement of Assets)* dhe *Forma 6 Pasqyra e balancave të aktiveve të qëndrueshme dhe ndryshimeve gjatë vitit (Form 6 Statement of Fixed Assets' Balance and Changes during the year)*, llogari grupi 20 dhe 21,23,24,28 përkatësisht.

Amortizimi i akumuluar për aktivet e patrupëzuara paraqitet në llogarinë numër 209 në Formën 1, ndërsa amortizimi i akumuluar për aktivet e trupëzuara paraqitet në llogarinë numër 219.

Ndryshimet në amortizimin e akumuluar për aktivet e trupëzuara dhe të patrupëzuara paraqiten në *Formën 7 Pasqyra e Aktiveve të Qëndrueshme* (*Form 7 Statement of Fixed Assets*).

Sipas Udhëzimit 14, projektet në proçes paraqiten nën llogarite 230 dhe 231 për Aktivet e qëndrueshme të Patrupëzuara dhe të Trupëzuara përkatësisht. Sapo projektet përfundojnë, transferohen në llogaritë përkatëse të aktiveve të qëndrueshme.

Nga faza pilote, ne kuptojmë që NJQV-të nuk mbajnë llogari për fazat e transferimit të aktiveve individuale, pronësia e të cilave i është besuar NJQV-së nga Këshilli i Ministrave. Është raportuar nga zyrtarët e NJQV-së që pjesa më e madhe e aktiveve subjekt i transferimeve është regjistruar në Pasqyrat financiare të NJQV-së.

Në shtojcën 4, paraqitet një udhëzues i shkurtër rreth vlerësimit të aktiveve të transferuara nga qeverisja qendrore, të cilën NJQV-të duhet ta marrin në konsideratë kur të vlerësojnë këto aktive.

Shembull:


Project STAR
Municipality of Pogradec
Notes to the Financial Statements
Reconciliation error

Back to main Index

Municipality of Pogradec
Notes to the Financial Statements
for the year ended 31 Dec 2013
(Amounts in ALL'000, unless otherwise stated)

Account numbers: 201 - 208
Supporting evidence: Fixed Assets Regsiter

Asset description	Category	Category cc Location	Purchase date	Depreciation rate	Date	Unit	Unit price	Cost	Accumulated depreciation as at 1 Jan 2013	Depreciation for year 2013	NBV as at 31 Dec 2013
studime azhornimi ish kampi i pion	Studies and researc	9		10.0%		-	-	209	-	-	-
studime azhornimi Peroi i caprazit	Studies and researc	9		10.0%		-	-	96	-	-	-
studime per asfaltime	Studies and researc	9		10.0%		-	-	99	-	-	-
Studime varrezat e popullit	Studies and researc	9		10.0%		-	-	198	-	-	-
studime hegu i liqenit	Studies and researc	9		10.0%		-	-	200	-	-	-
	Studies and researc	9		10.0%		-	-	800	-	-	-
studim azhornim nivelim i qytetit	Studies and researc	9		10.0%		-	-	194	-	-	-

7.2.9.2 Sh2 Lista e inventarit (N2 List of inventory)

Shkoni në faqen Sh2. Në varësi të informacionit të siguruar nga NJQV-ja, shtoni aq rreshta midis rreshtave 17 dhe 22 sa të jenë të nevojshëm për të paraqitur të gjitha të dhënat e marra. Selektoni rreshtat në krye dhe zgjeroni përzgjedhjen për të përfshire të gjithë rreshtat deri tek rreshti i “Total”-it. Shtypni Ctrl+D për të plotësuar formulat në rreshtat e shtuar rishtazi. Të dhënat duhet të plotësohen në kolonat C deri në F, dhe në kolonat H dhe I. Përdoruesi duhet të konfirmojë që formula e mbledhjes (SUM) në rreshtin e fundit mbledh të gjitha rreshtat që përmbajnë të dhëna në kolonën I.

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordon me pasqyrat financiare, formën 1 Pasqyra e aktiveve, llogaritë 31-39. Faqja *Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të vlerës totale të balancave të inventarit sipas faqes *F1*.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Në fund të vitit, diferenca ndërmjet totalit të inventarit të vitit aktual dhe të vitit paraardhës paraqitet nën llogarinë 63 në *Formën 3-1 Pasqyra e Shpenzimeve* (*Form 3-1 Statement of Expenses*). Nëse totali i inventarit është më i madh në vitin aktual, atëherë balanca në llogarinë 63 duhet të jetë negative, dhe e kundërta. Për më shumë informacion referojuni *Udhëzimit 14 Seksionit II, kapitullit 2, faqes 6, paragrafit 4.*

Në fund të vitit, në mënyre që të parandalohet impakti i ndryshimit te inventarit mbi rezultatin financiar vjetor, sipas Udhëzimit 14, është e nevojshme që NJQV-ja të kryejë rregullimet (sistemimet) duke përdorur llogaritë 8423 ose 841 dhe të transferojë impaktin në fondin bazë duke përdorur llogarite 1011 ose 1012. Për më shumë informacion referojuni *Udhëzimit 14 Seksionit II, kapitullit 3, faqes 12, paragrafit 1*.

Shembull:

Project STAR
Back to mai
xxx
Supporting evidence to be provided by the LGU
Reconciliation error

xxx
Supporting evidence to be provided by the LGU
for the year ended 31 Dec 2013
(Amounts in ALL'000, unless otherwise stated)

Account number: 31 and 32
Supporting evidence: Detailed listing of materials and inventory objects

No	Item description	Location	No of items	Cost per item	Balance as at 31 Dec 2013
			1	*2*	*3 = 1 x 2*
1	Makine llogaritse	A.Topalli	1	2	2
2	Disqe dokumentari/20000	Erjon Vesho	5	20	100
3	Disqe dokumentar/50000	Erjon Vesho	4	50	200
4	Tabele pecikllas/93600	Erjon Vesho	2	47	94
5	Tabele pecikllas/19200	Erjon Vesho	1	19	19
6	Tabele informacioni/1200	Erjon Vesho	42	1	50
7	Stativ/12000	Erjon Vesho	3	12	36
8	Platin odiziv/1080	Erjon Vesho	1	1	1
9	Tapet/8000	Klotilda Neziri	1	8	8
10	Printim banderole/9500	Arben Braho	3	10	29

7.2.9.3 Sh3 Të arketueshme nga punonjesit, parapagesa dhe gjoba (N3 Receivables from employees, prepayments and penalties)

Shkoni në faqen Sh3. Në varësi të informacionit të siguruar nga NJQV-ja, shtoni aq rreshta midis rreshtave 27 dhe 88 sa të jenë të nevojshëm për të paraqitur të gjitha të dhënat e siguruara. Selektoni rreshtat në krye (rreshti 27) dhe zgjeroni përzgjedhjen për të përfshire të gjithë rreshtat deri tek rreshti i "Total"-it. Shtypni Ctrl+D për të plotësuar formulat në rreshtat e shtuar rishtazi. Të dhënat duhet të plotësohen në kolonat C, D dhe në kolonat I deri në L, duke nisur nga rreshti 27. Përdoruesi duhet të konfirmojë që formula e mbledhjes (SUM) në rreshtin e fundit mbledh të gjitha rreshtat që përmbajnë të dhëna në kolonën L.

Të dhënat e përmbledhura duhet të paraqiten në rreshtat 17-21 dhe të lidhen me të dhënat në tabelën e mëposhtme.

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordon me pasqyrat financiare. Faqja *Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të vlerës totale të të arketueshmeve nga balancat e punonjësve sipas faqes F1.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Të rishikohet detajimi i paraqitur nën ketë Shënim, të kuptohet natyra e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe të diskutohet vjetërsia me përfaqësuesit e NJQV-së në lidhje me mundësinë për të arkëtuar.

Në lidhje me politikën e kontabilizimit dhe zhvlerësimit referojuni *Shënimit 4 Debitorë të ndryshëm* (*Note 4 Different debtors*).

Shembull:



Project STAR
Municipality of Ura Vajgurore
Supporting evidence to be provided by the LGU
Reconciliation error

Back to main Index

Municipality of Ura Vajgurore
Supporting evidence to be provided by the LGU
for the year ended 31 Dec 2013
(Amounts in ALL'000, unless otherwise stated)

Account number: 423
Supporting evidence: Receivables from employees, prepayments and penalties

Debtor	Originating date	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013
Overpayments to suppliers:									
"FIRMA" BESLIDHJA"	Pre 2006	185	-	-	185				
"NELSON SHPK	Pre 2006	395	-	-	395				
"FIRMA" KORA SHPK"	Pre 2006	408	-	-	408				
Overpayments to employees pre 2007	Pre 2007	212	-	-	212				
Overpayments of employees after 2007 and before 2010	2007-2010	41	-	-	41				
Total		1,240	-	-	1,240				

Deb		Originating date	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013
1	ARBEN TUMANI		-	-	-	2				1,608
2	SKENDER AVDURRAMANI		-	-	-	0				216
3	ADRIAN PILO		-	-	-	2				2,000
4	DRITAN TOSKA		-	-	-	2				2,268
5	HYSEN ZEBA		-	-	-	3				1,778

Sh4 Debitorë të ndryshëm (N4 Different debtors)

Shkoni në faqen Sh4. Në varësi të informacionit të siguruar nga NJQV-ja, shtoni aq rreshta midis rreshtave 16 dhe 36 sa të jenë të nevojshëm për të paraqitur të gjitha të dhënat e siguruara. Selektoni rreshtat në krye (rreshtin 16) dhe zgjeroni përzgjedhjen për të përfshire të gjithë rreshtat deri tek rreshti i "Total"-it. Shtypni Ctrl+D për të plotësuar formulat në rreshtat e shtuar rishtazi. Të dhënat duhet të plotësohen në kolonat C, D dhe ne kolonat I deri ne L. Përdoruesi duhet të konfirmojë që formula e mbledhjes (SUM) në rreshtin e fundit mbledh të gjitha rreshtat që përmbajnë të dhëna në kolonën L.

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordon me pasqyrat financiare. Faqja *Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të vlerës totale të balancave të debitorëve të ndryshëm sipas faqes F1.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Të rishikohet detajimi i paraqitur nën ketë Shënim, të kuptohet natyra e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe të diskutohet maturimi me përfaqësuesit e NJQV-së në lidhje me mundësinë për të arkëtuar.

Aktualisht nuk ka Udhëzime nga Ministria e Financave në lidhje me zhvleresimin e aktiveve. Nëse Udhëzime ose sqarime të reja do të miratohen, shikoni kërkesat dhe vlerësoni rregullimet (sistemimet) e mundshme për të riparaqitur shifrat e 2014.

Edhe pse Pasqyra e të Ardhurave përgatitet në bazë paraje, sipas kushteve të ligjit Nr. 9936/26.6.2008 "Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", NJQV-të janë të detyruara të njohin balancat e arkëtueshme dhe t'i paraqesin ato në pasqyrat e aktiveve.

Instruksionet në Udhëzimet 14 dhe 26, nuk specifikojnë qartësisht si të kontabilizohet në anën kreditore.

Nëse Udhëzime ose sqarime të reja do të miratohen, shikoni kërkesat dhe vlerësoni rregullimet (sistemimet) e mundshme për të riparaqitur shifrat e 2014.

Kjo është e aplikueshme ndaj të gjitha balancave të arkëtueshme të njohura, duke përfshire ato të paraqitura në Shënimet 3 dhe 4.

Shembull:



Project STAR
xxx
Supporting evidence to be provided by the LGU
Reconciliation error

Back to main Index

xxx
Supporting evidence to be provided by the LGU
for the year ended 31 Dec 2013
(Amounts in ALL'000, unless otherwise stated)

Account number: 468
Supporting evidenc Detailed list of debtors

No	Debtor	Originating date	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013	Balance as at 1 Jan 2013	Additional charge for the year	Payments during the year	Balance as at 31 Dec 2013
1	Mangalina Cane Pogradec		-	-	-	757				756,895
2	Rajmond Mato Pogradec		-	-	-	45				45,000
3	"Arbona " sh.p.k		-	-	-	428				428,405
4	Maksi Jazelli		-	-	-	32				31,600
5	Debitor Firma Zhobro		-	-	-	444				443,648
6	Debitor Firma KREK Albert Xhem		-	-	-	1,788				1,787,672
7	"Eneal"Sh.P.K		-	-	-	56				55,980
8	Diana Trajani		-	-	-	8				8,209
9	Oresti Samsuri		-	-	-	6				6,469
10	Arben Oshafi		-	-	-	7				7,339

7.2.9.4 Sh5 Akti i trashëgimisë (N5 Inheritance act)

Shkoni në faqen N5. Të dhënat duhet të plotësohen në qelizat boshe në kolonat Q, R, U, V, Y dhe Z.

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordohet me Pasqyrat financiare. Faqja *Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të shumës totale të balancave të trashëguara sipas faqes F1.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Akti i trashëgimisë nënshkruhet midis NJQV-së dhe Thesarit në fund të çdo viti, duke konfirmuar lëvizjet në para.

Ky Shënim do të paraqesë më në detaje balancën e parasë të mbartur nga viti paraardhës dhe gjithashtu balancën e parasë në fund të vitit, të paraqitur në tabelën e Pasqyrës së Aktiveve (Statement of Assets) nën llogarinë 520, e cila mbartet në vitin pasardhës. Gjithashtu paraqet lëvizjet në para të mbajtura si garanci për përfundimin e punës, të paraqitur në formën 2 Pasqyra e Fondeve dhe Detyrimeve (Statement of Funds and Liabilities) nën llogarinë nr. 466.

Balancat hapesë dhe mbyllëse të parasë sipas aktit të trashëgimisë duhet gjithashtu të rakordohen me formën 5 Pasqyra e flukseve monetare (Statement of Cash Flows).

Shembull


Project STAR
xxx
Supporting evidence to be provided by the LGU
Reconciliation error
Back to main index
Municipality of Ura Vajgurore
Supportive evidence to be provided by the LGU
For the year ended 31 Dec 2013
(AMOUNTS IN ALL 000, UNLESS OTHERWISE STATED)
Account number: 520
Supporting evidence: Inheritance Act - from 2012 to 2013
Inherited from 2012
Budget for 2012
Total revenue for 2012 and 2013
Used during 2013
Balance to be carried forward
Grant plus revenue (Chapter 8)
Chapter 6
Total for 2012
Description
Grant plus revenue b/fdown 2012
Cooperative grants
Budgeted grant for 2013
Realized revenue
Participation of institutions
Revenue from 'ALUIZNI'
Other
Balance - chapter 8
5% Completion Guarantee
Interest reserves
Sponsorships
Other deposits
Other
Balance - chapter 6
:

7.2.9.5 Kreditorët (N6 Creditors)

Shkoni në faqen N6. Në varësi të informacionit të siguruar nga NJQV-ja, shtoni aq rreshta midis rreshtave 17 dhe 300 sa të jenë të nevojshëm për të paraqitur të gjitha të dhënat e siguruara. Selektoni rreshtat në krye (rreshtin 17) dhe zgjeroni përzgjedhjen për të përfshire të gjithë rreshtat deri tek rreshti i "Total"-it. Shtypni Ctrl+D për të plotësuar formulat në rreshtat e shtuar rishtazi. Të dhënat duhet të plotësohen në kolonat C deri ne H dhe ne kolonat M deri ne O. Përdoruesi duhet të konfirmojë që formula e mbledhjes (SUM) në rreshtin e fundit mbledh të gjitha rreshtat që përmbajnë të dhëna në kolonën L.

Në vijim, përdoruesi duhet të kontrollojë nëse informacioni rakordon me pasqyrat financiare. *Faqja Kontrolle (Checks)* ofron një rakordim të paracaktuar të vlerës totale të balancave të kreditorëve të ndryshëm sipas faqes F2.

Në rast se shfaqen diferenca, përdoruesi duhet të ndjekë çështjen me NJQV-në në lidhje me natyrën e gabimit.

Të rishikohet detajimi i paraqitur nën ketë Shënim, të kuptohet natyra e këtyre llogarive të pagueshme dhe të diskutohet rreth arsyeve të mospagimit të tyre.

Në lidhje me me datën e pagesës të faturave me vonesë, diskutoni me NJQV-në dhe kërkojini që të rishikojë dispozitat dhe kushtet e kontratave përkatëse, si edhe faturat e lëshuara, dhe kërkojini NJQV-së të vlerësojë penalitetet e mundshme që mund të lindin si rrjedhojë e faktit që pagesa nuk është kryer ende. Rishikoni penalitetet e vlerësura dhe vlerësoni nevojën për njohje në llogaritë kontabël dhe paraqitjen e një provigjoni në formën 2 Pasqyra e fondeve dhe detyrimeve (Statement of funds and liabilities).

Aktualisht nuk ka Udhëzime nga Ministria e Financave në lidhje me njohjen, matjen dhe paraqitjen e provigjoneve. Nëse Udhëzime të reja do të miratohen, shikoni kushtet dhe vlerësoni rregullime (sistemime) të mundshme për të riparaqitur shifrat e 2014.

Shembull:



Project STAR
Municipality of Ura Vajgurore
